



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 32/2020 regjistër (JR)  
Datë 31.08.2020

Nr. 37 i vendimit  
Datë 11.10.2022

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 11.10.2022, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit që i përket:

**ANKUESE:** Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 259, datë 15.06.2020.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, paragrafi 2 i Kushtetutës; neni F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës; nenet 58, pika 1, shkronja “a”, 59, 63 dhe 66, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, shqyrtoi pretendimet e kërkimet e subjektit të rivlerësimit të paraqitura në ankim, si dhe në parashtrimet para seancës, dëgjoi relatoren e çështjes, gjyqtaren Ina Rama, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), në momentin e hyrjes në fuqi të nenit 179/b të Kushtetutës, të miratuar me ndryshimet kushtetuese me anë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, ushtronte detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe, për shkak të këtij funksioni, në zbatim të nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex-officio* nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”). Për subjektin e rivlerësimit, nga Komisioni janë zhvilluar hetime vetëm për një nga tri kriteret e rivlerësimit, përkatësisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin gjendet i administruar në fashikull edhe raporti i përgatitur nga ILDKPKI-ja.
2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja<sup>1</sup>, në përputhje me pikën 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit është konstatuar se:
  - o deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka veprime fiktive dhe mashtrim për përfitime të padrejta;
  - o nuk ka burime financiare të ligjshme;
  - o ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite;
  - o ka kryer deklaram të rremë;
  - o subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

### II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 259, datë 15.06.2020, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.*
4. Vendimi për subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, është marrë nga Komisioni bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin është konkluduar se:
  - 4.1 Për pasurinë nr. {\*\*\*}, apartament banimi me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë:
    - i) ka kryer deklaram të pasaktë të kësteve të paguara në vitet përkatëse dhe, për rrjedhojë, të vlerës reale të çmimit të paguar për këtë pasuri, në kundërshtim me parashikimin e gurmës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri sipas nenit “D” të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
    - ii) nuk arriti të provojë destinacionin e kredisë së përfituar në shumën 2.500.000 lekë në Alpha Bank dhe, për pasojë, nuk arriti të shpjegojë bindshëm njërin prej burimeve të kësaj pasurie (deklaruar me këtë kredi), duke u gjendur në kundërshtim me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
    - iii) nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.200.000 lekë, deklaruar si hua e marrë shtetases G. N. dhe, për pasojë, kjo shumë nuk u përfshi në analizën financiare të vitit 2010;
    - iv) për vitin 2010, gjendet në balancë negative në shumën 1.593.639 lekë;
    - v) mospërputhjet e deklaramit të subjektit se, në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave, nuk ka fatura, pasi këta libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme, me veprimin e kryer gjatë hetimit, ku depozitoi 25 mandatpagesa, ndikojnë në vlerësimin etik të subjektit të rivlerësimit.

<sup>1</sup> Raport i përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 31.05.2018.

**4.2** Për pasurinë e renditur me nr. {\*\*\*}, në rrugën "{\*\*\*}", në Tiranë:

*Veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese për të financuar blerjen e një banese tjetër në Tiranë, që, nga hetimi administrativ, subjekti rezulton t'i ketë në pronësi të tij, janë kryer në tejkalim të parashikimeve ligjore mbi përfitimin e kredisë.*

**4.3** Për balancën negative të vitit 2012, në shumën (-)295.638 lekë, dhe derdhjen e shumës 101.000 lekë në llogarinë e kredisë në Alpha Bank më 11 janar 2006, subjekti nuk provoi me dokumentacion justifikues balancën negative, konfirmuar në arsyetimet më sipër.

5. Në përfundim, lidhur me kriterin e pasurisë, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm dhe ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, si dhe arrin në konkluzionin se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke bërë kështu të aplikueshme kërkesat e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

### **III. Shkaqet e ankimit**

6. Kundër vendimit të Komisionit nr. 259, datë 15.06.2020, ka paraqitur ankim subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi. Nga analizimi i përmbajtjes së ankimit, konstatohet se ai përmban pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor, për mosqenien e saj në kushtet e cenimit të besimit të publikut, si dhe pretendime që kundërshtojnë konkluzionet e Komisionit për vlerësimin e pasurisë.

7. Me ankimin, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim "Kolegji"):

(i) *Përfundimin e hetimit edhe për dy kriteret tjera të rivlerësimit – të kontrollit të figurës dhe të aftësive profesionale, dhe ndryshimin e vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, e konfirmimin në detyrë; ose:*

(ii) *Prishjen e vendimit nr. 259, datë 15.06.2020 dhe dërgimin e çështjes Komisionit për të vazhduar më tej me procedurën e rivlerësimit për kriteret e mbetura pa u vlerësuar.*

#### **A. Shkaqe të ankimit lidhur me procesin e rregullt ligjor**

8. Në drejtim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, lidhur me gjykimin e çështjes së saj nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, pretendon se: **(i)** vetëm në rastin kur Komisioni ka realizuar detyrimin kushtetues dhe ligjor për vlerësimin e subjektit për të tria kriteret, përkatësisht për kontrollin e pasurisë, figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, atëherë ky organ mund të konkludojë nëse është cenuar ose jo besimi i publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016; **(ii)** nga analizimi i përmbajtjes së nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, del e qartë se deklarimi i pamjaftueshëm aplikohet për të dyja kriteret, për kontrollin e pasurisë dhe të figurës, dhe se në kushtet kur subjekti është hetuar vetëm për një kriter, atë të pasurisë, Komisioni e ka keqaplikuar këtë dispozitë; **(iii)** Komisioni i ka cenuar subjektin të drejtën për t'u dëgjuar. Me mënyrën si u zhvillua seanca dëgjimore, kjo e drejtë nuk gjeti aplikim, pasi seanca nuk u përfundua asnjëherë, por u ndërpre për një vendimmarrje lidhur me një kërkesë procedurale, dhe pa e përfunduar seancën dëgjimore, trupa gjyquese e Komisionit shpalli vendimin përfundimtar.
9. Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer një hetim të mangët, pasi: **(i)** hetimi është i paplotë dhe nuk u është referuar provave të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit; **(ii)** hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, nuk ka qenë i gjithanshëm dhe i pavarur, por ai rezulton të jetë bazuar tërësisht te raporti i ILDKPKI-së; **(iii)** Komisioni në asnjë moment nuk më ka bërë me dije se hetimi administrativ ndaj meje ka përfunduar, por më ka përcjellë vetëm

rezultatet paraprake të hetimit; (iv) Komisioni nuk u shpreh në asnjë moment procedural lidhur me kërkesën për riçelje të hetimit administrativ dhe paraqitjen e provave të reja.

## **B. Shkaqe të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë**

10. **Për pasurinë apartament banimi me sip. 57 m<sup>2</sup>, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë,** përfituar me kontratën e sipërmarrjes, datë 21.09.2004, me vlerë 39.000 euro, sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, konkluzioni i Komisionit është i pasaktë, në drejtim të elementeve që kanë të bëjnë me:
- (i) konsiderimin e mandatit të fundit, me vlerë 8000 euro, si një vlerë shtesë në pagesën e kryer për blerjen e këtij apartamenti, duke e rritur në mënyrë fiktive shumën reale të paguar, prej 39.000 eurosh në 47.000 euro;
  - (ii) moskonsiderimin e shpjegimit të dhënë nga subjekti për marrjen mbrapsht të vlerës 8000 euro nga shuma e paguar për apartamentin deri më 23 maj 2005 për nevoja familjare, e cila është e faktuar me mandatpagesën nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, si dhe me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2020, të përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK;
  - (iii) mosdeklarimin në deklaratën e pasurisë *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”) të marrjes nga shoqëria e ndërtimit të shumës prej 8000 eurosh në vitin 2006, e cila po në këtë vit iu kthye kësaj shoqërie, është një lapsus i cili nuk duhet të ndikojë në procesin e saj të rivlerësimit, për sa kohë kjo lëvizje e fondeve faktohet me dokumente të kohës kur ka ndodhur ky veprim;
  - (iv) faktin se Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të provave, dokumenteve spitalore, lidhur me shëndetin e gjyshes, të cilat provojnë nevojën që ka diktuar kërkesën e subjektit për të marrë nga shoqëria e ndërtimit shumën prej 8000 eurosh nga shuma e paguar më parë prej saj;
  - (v) arsyetimin e Komisionit lidhur me destinacionin e kredisë së marrë nga Banka Alpha, i cili është i gabuar pasi subjekti ka pasur detyrimin të deklaronte burimet e financimit të pasurisë dhe jo të paraqiste dokumentacion për të qartësuar veprimet pas disbursimit të kredisë, për të provuar kalimin e saj në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit;
  - (vi) faktin se, për burimin e të ardhurave nga shitja e librave, çdo aludim i Komisionit lidhur me këto të ardhura, është i pabazuar pasi subjekti ka provuar me dokumentacion provues ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016;
  - (vii) kundërshtimin e konkluzionit të Komisionit për huan e marrë nga kushërira e saj, znj. G. N., në shumën 1.200.000 lekë, duke pretenduar se me shpjegimet e dhëna, si dhe me dokumentacionin e dorëzuar në Komision, ajo ka mundur të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
11. Subjekti kundërshton analizën financiare të Komisionit për vitet 2006, 2010 dhe 2012, lidhur me përlllogaritjen e zërave të caktuar të saj, duke pretenduar se nëse do të vlerësoheshin pretendimet e saj, analiza financiare do të rezultonte pozitive për këto vite.
12. Lidhur me kredinë prej 5.000.000 lekësh, të përfituar me kushte lehtësuese në zbatim të VKM-së 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë”, ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, subjekti i rivlerësimit pretendon se është marrë në përmbushje të kushteve ligjore e situatës faktike që ky akt nënligjor kërkon.
13. Subjekti i rivlerësimit kërkon që mospërputhjet e deklarimit të subjektit në ILDKPKI në vitin 2012, me ato të dhëna përgjatë hetimit administrativ në Komision për automjetin, tip “Benz 2000”, me targë {\*\*\*}, të konsiderohen si pasaktësi që nuk mund të afektojnë procesin e saj të rivlerësimit.
14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e Komisionit për blerjen e automjetit “Opel Corsa” në vitin 2005, si jo të drejtë dhe të pabazuar në prova dhe ligj.

#### IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

##### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

###### a) Juridiksioni i Kolegjit

15. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

###### b) Legjitimimi i ankuesit

16. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

###### c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

17. Në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit të Komisionit nr. 259, datë 15.06.2020, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi.

17.1 Kolegji shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja bashkëlidhur ankimit, si dhe kërkesën për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike. Kërkesën për shqyrtimin e provave të reja të paraqitura me ankimin, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, e mbështet mbi argumentin se këto akte nuk ka mundur t'i paraqesë në Komision, për shkak se nga ky organ nuk u pranua kërkesa e saj për riçeljen e hetimit administrativ dhe, për pasojë, nuk iu la mundësi për paraqitjen e akteve, të cilat subjekti i ka bashkëlidhur me ankimin<sup>2</sup>. Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në zbatim

---

<sup>2</sup> Bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet:

1. Kontratë sipërmarrjeje, me nr. {\*\*\*} rep., datë 09.02.2005, me palë sipërmarrëse shoqëria "{\*\*\*}" ShPK dhe porosites D. Q., për blerje apartamenti, me sipërfaqe 115 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 53.000 euro.
2. Kontratë sipërmarrjeje me nr. {\*\*\*} rep., datë 25.08.2004, me palë sipërmarrëse shoqëria "{\*\*\*}" ShPK dhe porosites S. Z., për blerje apartamenti, me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, me vlerë totale 25.500 euro.
3. Raport nr. {\*\*\*} prot., i datës 27.05.2019, i KLGj-së, "Për analizën e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi", për periudhën 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016 (30 faqe).
4. Raport i përpiluar nga DSIK-ja, sipas të cilit është konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, rezulton e përshtatshme për të vazhduar detyrën.
5. Vërtetim nr. {\*\*\*} i Bankës Alpha, dega Berat, i datës 27.07.2020, i cili vërteton faktin se administratori i shoqërisë "{\*\*\*}", z. A. Y. është klient i kësaj banke që nga viti 07.11.2002.
6. Ekstrakti Historik i regjistrit tregtar për subjektin "{\*\*\*}", nxjerrë më datë 28.07.2020 nga Qendra Kombëtare e Biznesit.
7. Vërtetim nga Dega Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Berat për të provuar kohën që subjekti është paguar me leje lindjeje, shtator 2012 - tetor 2013.

të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, referon si shkak që për ligj mungesën e fajit, faktin që seanca dëgjimore e zhvilluar në Komision, u pezullua me qëllim shqyrtimin e kërkesës së saj paraprake për riçeljen e hetimit gjyqësor dhe se ajo nuk rifilloi me zhvillimin e saj normal, përgjatë së cilës subjekti do të jepte shpjegime dhe prova të mëtijshme mbi rezultatet paraprake të hetimit, por vijoi me seancën e radhës, tek e cila Komisioni shpalli vendimin përfundimtar për zgjidhjen e çështjes. Kjo situatë konsiderohet prej subjektit se përmbush kriteret e nenit 51, pika 1/a e ligjit nr. 49/2012 dhe, për pasojë, ajo kërkon që çështja të shqyrtohet nga Kolegji në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve.

**17.2** Në funksion të shqyrtimit të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, që lidhet me rregullshmërinë e zhvillimit të seancës dëgjimore në Komision, Kolegji verifikoi procesverbalin e seancës, si edhe përmbajtjen e deklarimeve të bëra në të, nëpërmjet dëgjimit të regjistrimit audio, proces nga i cili rezultoi se pretendimi i subjektit nuk është i mbështetur në fakte. Nga këto burime të verifikuara prej Kolegjit, konstatohet se në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni më datë 05.06.2020, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur prova të reja (të cilat rezultojnë të jenë të ndryshme nga ato që subjekti ka paraqitur së bashku me ankimin) dhe trupa gjyqësore e Komisionit, përgjatë seancës, është tërhequr dhe ka vendosur në lidhje me administrimin e tyre. Në përfundim të seancës dëgjimore, konstatohet se trupa gjyqësore e Komisionit e ka ftuar subjektin për të dhënë qëndrimin përfundimtar. Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore të administruar në fashikull, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, të ketë kërkuar prej Komisionit të shprehet për kërkesën e saj për riçelje të hetimit për dy kriteret e tjera, por ajo ka vijuar seancën duke e përmblytur atë me qëndrimin përfundimtar mbi procesin e saj të rivlerësimit, duke kërkuar konfirmimin në detyrë. Në mbështetje të këtyre fakteve që rezultojnë nga aktet procedurale të ndodhura në fashikull, Kolegji e gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, se mospasja faj për mosparaqitjen e këtyre provave të reja që në fazën e hetimit administrativ, lidhet me paqartësinë që i ka dhënë asaj zhvillimi i seancës dëgjimore në Komision.

8. *Certifikatë vdekjeje për znj. F. K., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. 1 Berat, e datës 30.07.2020. Me këtë provë shkresore, provohet fakti se datëlindja e znj. F. K. është 25.09.2021 dhe data e vdekjes është 04.09.2008.*
9. *Shkresë e KPK-së me nr. {\*\*\*} prot., e datës 29.07.2020, "Kthim përgjigjeje kërkesave tuaja nr. {\*\*\*} prot., datë 27.7.2020 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 28.7.2020".*
10. *Kopje e printuar nga sistemi, faqja zyrtare e KPK-së, mbi njoftimin e seancës për shpallje vendimi për subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi.*
11. *Deklaratë noteriale me nr. rep. {\*\*\*} dhe nr. kol. {\*\*\*}, e datës 30.07.2020, e lëshuar nga deklaruesi G. Sh. para noteres H. B.*
12. *Deklaratë noteriale e nënshkruar nga subjekti fizik, me aktivitet privat "Marangoz", për të provuar faktin se kundrejt pagesës sime të kryer në vitin 2011, prej 300.000 lekësh, kemi porositur një dhomë gjumi dhe një kuzhinë, mobilie këto që i janë dorëzuar subjektit në vitin 2012.*
13. *Notë verbale NV N 057/2010, lëshuar nga Bashkimi Evropian, me anë të së cilës Delegacioni i BE-së në Shqipëri i shpreh përgëzimet e saj Ambasadës së Republikës Kroate dhe bëjnë me dije se cilët do të jenë zyrtarët shqiptarë që janë ftuar të marrin pjesë në Ragion Workshop, on IPR Crime – JHA 41361, që do të mbahet në Zagreb, Kroaci, nga dt. 27 deri më 29 prill 2010.*
14. *Deklaratë noteriale nr. rep. {\*\*\*} dhe nr. kol. {\*\*\*}, dt. 4.8.2020, nënshkruar nga administratorja e subjektit tregtar "{\*\*\*}", me NIPT {\*\*\*}, me seli në Kuçovë, Berat, për të provuar faktin se kundrejt pagesës së kryer në vitin 2011, prej 300.000 lekësh, prej subjektit është porositur një dhomë gjumi dhe pajisje elektro-shtëpiake e dollapë.*
15. *Ftesë nominale nga Komisioni Evropian, e datës 13 prill 2010, Bruksel, e lëshuar në emër të bashkëshortit të subjektit, z. E. K..*
16. *Shkresë nr. {\*\*\*}, e datës 28.07.2020, lëshuar nga KLGj-ja.*
17. *Kopje të e-mail-eve të drejtuara nga KPK-ja subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, gjatë procesit të rivlerësimit, në adresën elektronike të subjektit, si në vijim: e-mail i datës 15.10.2019, e-mail i datës 14.2.2020, e-mail i datës 24.2.2020, e-mail i datës 26.2.2020, e-mail i datës 26.2.2020 mbi kërkesën e subjektit për riçelje hetimi, e-mail i datës 12.06.2020, për rifillim të seancës dëgjimore (e-mail-i i fundit i komunikuar nga KPK-ja në adresën elektronike të subjektit).*

Rezulton se subjekti ka paraqitur prova të reja në seancën dëgjimore, të adresuara drejt kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke i konsideruar ato shteruese në drejtim të këtij kriteri, të cilat janë administruar dhe vlerësuar prej Komisionit. Pretendimi i subjektit në seancë, ashtu si edhe gjatë hetimit administrativ, dhe i refuzuar prej Komisionit, ka qenë i lidhur me hetimin e dy kritereve të tjera të procesit, rrethanë që rezulton të mos ketë krijuar asnjë pengesë apo të ketë vënë në pamundësi subjektin për paraqitjen e provave të tjera lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

**17.3** Kolegji shqyrtoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen me cilësinë e provës së re të akteve që kanë shoqëruar ankimin dhe e vlerësoi atë në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, sipas përcaktimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, në të cilin parashikohet se: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit – dhe konstatoi se provat e paraqitura nuk plotësonin kriteret e parashikuara nga dispozitat e cituara për të gëzuar statusin e provës së re që mund të merret në gjykimin në apel të çështjes. Subjekti nuk ka provuar se ekzistojnë kriteret e parashikuara nga neni 47 i ligjit nr. 49/2012 dhe, për më tepër, nga analiza e akteve në raport me faktet që subjekti synon të provojë me to, Kolegji arriti në konkluzionin se ato janë të parëndësishme për zgjidhjen e çështjes, për pasojë vendosi të mos e pranojë këtë kërkesë të subjektit.*

**17.4** Në përmbyllje të sa referuar më sipër, në drejtim të garantimit të të drejtave të subjektit për t'u mbrojtur lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë për të cilin i kishte kaluar barra e provës, mungesa e mosspecifikimit prej Komisionit në përmbyllje të seancës dëgjimore apo në aktin e njoftimit, se në seancën e radhës do të shpallet vendimi përfundimtar në raport me të gjitha faktet procedurale që rezultojnë të dokumentuara në aktet e fashikullit, është një element që nuk cenon të drejtat e subjektit të rivlerësimit, madje vjen në përputhje me parashikimin e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016 e në koherencë të plotë me procedurën e aplikuar nga Komisioni në të gjitha proceset e rivlerësimit të zhvilluara tashmë. Në analizë të të gjitha pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, të prezantuara si më sipër, Kolegji e gjeti të pambështetur në fakte e në nenin 51, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 49/2012, kërkesën e saj për gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike e për marrjen e provave të reja.

**17.5** Kolegji, në konkluzion të arsyetimit të mësipërm, vendosi të vijojë ta shqyrtojë çështjen në formën e gjykimit të zhvilluar në dhomë këshillimi, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

## **B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit**

### **I. Shkaqe lidhur me pretendimet për cenim të parimeve të procesit të rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit**

- 18.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, *se konkluzioni i Komisionit, sipas të cilit ajo ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në kushtet kur subjekti është rivlerësuar vetëm për një kriter, përkatësisht për kontrollin e pasurisë, është i gabuar e në kundërshtim me parashikimet ligjore, Kolegji analizon sa vijon.*

**18.1.** Komisioni, në vendimin objekt shqyrtimi, për subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në seksionin “Vlerësimi tërësor i çështjes”, ka konkluduar sa vijon:

*[...] Në përfundim, Komisioni ka konkluduar se:*

*Lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm dhe ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në vlerësimin e pasurisë, si dhe arrin në konkluzionin se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, duke bërë kështu të aplikueshme kërkesat e pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

**18.2** Referuar arsytimit të vendimit të Komisionit, vërehet se nga hetimi administrativ, është konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka probleme me justifikimin e burimeve të financimit të pasurisë, si dhe me saktësinë e deklarimeve të saj në deklaratën vetting dhe në deklaratat periodike vjetore të pasurisë dhe interesave (në vijim “DPV”). Për këtë arsye, Komisioni ka mbyllur hetimin administrativ vetëm për një kriter, përkatësisht duke u bazuar vetëm në rezultatet për vlerësimin e pasurisë, mbi të cilin gjithashtu ka mbështetur edhe aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Në këtë kuptim, në vijim të analizimit të këtij shkak ankimi, Kolegji vlerëson se po të njëjtat shkaqe/elemente nuk mund të konsiderohen edhe si shkaqe për të shkuar drejt arsytimit se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila gjen aplikim për të kualifikuar situata faktike të cilat nuk mund të kualifikohen sipas përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 dhe 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

**18.3** Në vijim të këtij arsytimi, Kolegji çmon gjithashtu se vetë përcaktimi i nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, kërkon që prej Komisionit, konkluzioni për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duhet të jetë një produkt i dalë mbi vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit ose tërësor të procedurave. Duke u bazuar në këtë përcaktim, rezulton se konkluzioni se subjekti ka cenuar besimin e publikut duke u gjendur në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, arrihet pas një vlerësimi të përgjithshëm të tri kriterëve kur konkludohet se problematikat e konstatuara në drejtim të kontrollit të pasurisë, figurës apo aftësive profesionale, nuk mund të përbëjnë shkak shkarkimi më vete, por nga ana tjetër, ato mbartin elemente të mjaftueshme që, pas vlerësimit tërësor të këtyre tri kriterëve, të konkludohet se subjekti i rivlerësimit, me sjelljen apo qëndrimet e tij, ka cenuar besimin e publikut në një nivel të tillë, të parikuperueshëm, aq sa kjo situatë të përcaktojë aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

**18.4** Në vijim, duke u kthyer në rastin objekt shqyrtimi, në kushtet kur Komisioni ka përfunduar hetimin administrativ vetëm mbi rezultatet e dala për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të cilat i ka konsideruar se mbartin mjaftueshëm elemente që justifikojnë aplikimin e masës disiplinore për deklarim të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe, në mungesë të kontrollit dhe vlerësimit, edhe për dy kriteret e tjera, Kolegji vlerëson se Komisioni ka qenë i pajustificuar ligjërisht për të konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, për sa kohë që nuk ka bërë një vlerësim të përgjithshëm të tri kriterëve. Gjithashtu, përderisa Komisioni, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka arritur në përfundimin se subjekti gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ai nuk mund të ndodhet edhe në kushtet e cenimit të besimit të publikut sipas pikës 5 të po këtij neni për të njëjtat problematika, duke e ndëshkuar në këtë mënyrë dy herë për të njëjtën shkelje, në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës.

**18.5** Në këto kushte, për këtë shkak ankimi, për të cilin tashmë ka edhe gjurmë të rëndësishme në jurisprudencën e tij<sup>3</sup>, Kolegji vlerëson se pretendimi i subjektit se Komisioni

---

<sup>3</sup> Shih vendimin e Kolegjit nr. (JR) 15/2019, datë 17.07.2019 dhe nr. (JR) 15/2021, datë 18.06.2021.



nuk ka aplikuar drejt ligjin, për sa kohë, bazuar në hetimin vetëm të kriterit të vlerësimit të pasurisë, ka indikuar si shkak për dhënien e masës disiplinore, përveç nenit 61, pika 3, edhe pikën 5 të tij, është i drejtë dhe i bazuar në ligj.

**18.6** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e subjektit se: *nga analizimi i përmbajtjes së nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, del e qartë se deklarimi i pamjaftueshëm aplikohet për të dyja kriteret, për kontrollin e pasurisë dhe të figurës, dhe se në kushtet kur subjekti është hetuar vetëm për kriterin e pasurisë, Komisioni e ka keqaplikuar këtë dispozitë, për të cilin arsyetohet si vijon.*

**18.7** Pretendimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit vjen në kundërshtim si me përcaktimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ashtu edhe me qëndrimin tashmë të konsoliduar të mbajtur në jurisprudencën e Kolegjit për këtë çështje. Kjo dispozitë ligjore përcakton qartazi se rivlerësimi është një proces i cili jo domosdoshmërisht fillon dhe finalizohet me shqyrtimin e 3 (tri) kriterëve të procesit të rivlerësimit. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë e në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili në pikën 1 parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Përcaktimi i nenit 59, i cili parashikon se për konfirmimin në detyrë të një subjekti, kërkohet domosdoshmërisht vlerësimi pozitiv për të tria kriteret së bashku, duke u interpretuar *a contrario*, lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit edhe mbështetur vetëm në një ose dy kritere, për ato raste kur, për Komisionin, rezulton se nga hetimet e kryera, subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm, duke e bërë konfirmimin në detyrë të pamundur.

Për sa arsyetuar më sipër, si dhe referuar në jurisprudencën e deritanishme të Kolegjit, ky pretendim i subjektit gjendet jo i drejtë dhe i pabazuar në ligj.

- 19.** Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit *për zhvillimin e një procesi të parregullt ligjor për sa i përket mënyrës dhe procedurës së zhvilluar gjatë seancës dëgjimore në Komision*, konstatohet e arsyetohet si vijon.

**19.1.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka pretenduar se Komisioni ka kryer shkelje ligjore gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, të cilat janë përkatësisht:

**(a)** Nuk ka zbatuar parashikimet e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se vendimi jepet në fund të seancës dëgjimore, pasi ai e dha vendimin pasi e ndërpreu atë dhe nuk u shpreh se seanca e radhës do të jetë për shpallje vendimi. **(b)** Seanca është mbyllur duke mos i dhënë përgjigje kërkesës së saj paraprake për çeljen e hetimit edhe për 2 (dy) kriteret e tjera, përkatësisht për kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. **(c)** Asnjëherë trupa gjyquese e Komisionit, si përgjatë seancës se vetme dëgjimore apo me *e-mail*, nuk ka deklaruar tërheqjen e trupës për shpallje të vendimit përfundimtar. **(ç)** Nuk i është komunikuar në adresën elektronike, siç e kërkon ligji, njoftimi për shpallje të vendimit. **(d)** Procesverbali i zbardhjes së seancës dëgjimore të Komisionit nuk pasqyron në mënyrë të saktë sa është deklaruar gjatë seancës, veçanërisht lidhur me pasqyrimin e qëndrimit të vëzhgueses ndërkombëtare.

**19.2.** Në analizë të këtyre pretendimeve, nga verifikimi i akteve të fashikullit të hetimit administrativ, Kolegji konstaton se, pas përfundimit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datën 05.06.2020, subjekti është njoftuar me *e-mail*-in e datës 12.06.2020, të emërtuar *Njoftim për rifillimin e seancës dëgjimore*, se seanca dëgjimore për të, do të rifillojë më datë 15.06.2020, ora 13:00, me vendndodhje te Pallati i Koncerteve, Kati I, Tiranë. Rezulton se Komisioni, kur ka deklaruar ndërprerjen e seancës dëgjimore, nuk ka përcaktuar ditën dhe orën e rifillimit të saj, por ka marrë kohë për të konkluduar mbi këtë çështje, duke shpjeguar gjithsesi mënyrën se si subjekti, por edhe publiku, do të njoftohet lidhur me rifillimin e saj. Kolegji çmon se nga

pikëpamja ligjore, kjo procedurë e ndjekur nga Komisioni lidhur me ndërprerjen e seancës dëgjimore, është në përputhje me përcaktimet e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon se: *Vendimi shpallet në fund të seancës dëgjimore*. Në këtë kuptim, ndërprerja e seancës dëgjimore nuk do të nënkuptojë përfundimin e saj, pasi kjo seancë konsiderohet e përfunduar më datë 15.06.2020, kur është shpallur vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi, për pasojë pretendimi i subjektit se kjo mënyrë e komunikimit të ndërprerjes së seancës në datën 05.06.2020, pa deklaruar mbylljen e saj, është e parregullt, nuk qëndron. Mënyra se si Komisioni ka administruar seancën dëgjimore vjen në përputhje e harmoni me parashikimin e ligjit, sipas të cilit seanca dëgjimore konsiderohet e mbyllur me shpalljen e vendimit përfundimtar. Njoftimi për ditën dhe orën e seancës, jo menjëherë, me ndërprerjen e saj, por me anë të komunikimit elektronik të mëvonshëm, nuk vlerësohet se cenon ndonjë të drejtë të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, për sa kohë që ajo i kishte realizuar të drejtat e saj procedurale, përfshi atë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore të zhvilluar. Komunikimi në adresën elektronike, sipas parashikimit të nenit 46 të ligjit nr. 84/2016, ka realizuar gjithashtu njoftimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, dhe ka siguruar prezencën e saj në seancën e ardhshme dëgjimore, në të cilën është shpallur vendimi i Komisionit për çështjen.

**19.3.** Nga pikëpamja e përmbushjes së standardeve ligjore, në kuptim të garantimit të së drejtës së subjektit për t'u mbrojtur e për t'u dëgjuar, Kolegji konstaton se përgjatë seancës dëgjimore, subjektit i është dhënë pa kufizime e drejta për të shpjeguar çështjet e ngritura në rezultatet paraprake të hetimit, lidhur me kontrollin e pasurisë, për të cilat Komisioni i ka kaluar barrën e provës. Subjekti i rivlerësimit, përgjatë seancës dëgjimore, ka paraqitur edhe prova të reja, të cilat ajo nuk i kishte paraqitur gjatë hetimit administrativ, në funksion të përbaljes me barrën e provës së kaluar prej Komisionit. Në përfundim të seancës dëgjimore, rezulton se ajo ka mbajtur edhe qëndrimin përfundimtar lidhur me procesin e saj të rivlerësimit, duke kërkuar konfirmimin në detyrë.

**19.4.** Në këto kushte, Kolegji vëren se i gjithë zhvillimi i seancës dëgjimore duket se nuk përmban situata që e kanë vendosur subjektin në kushtet e cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur në drejtim të kontrollit të pasurisë. I gjithë zhvillimi i seancës dëgjimore vlerësohet edhe në raport me faktin që mungesa e çeljes së hetimit për dy kriteret e tjera, nuk do të kishte ndonjë efekt në drejtim të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë, për të cilin subjekti ka pasur ndërveprim me Komisionin përgjatë gjithë hetimit administrativ, përfshi edhe seancën dëgjimore. Për më tepër, mbyllja e seancës dëgjimore prej Komisionit, duke ftuar subjektin për të dhënë konkluzionet përfundimtare, të cilat subjekti i ka dhënë duke kërkuar konfirmimin në detyrë, është një situatë e cila të krijon bindjen se subjekti ka pasur qartësi për mbylljen e procesit të rivlerësimit dhe një kuptim të plotë për qëllimin e seancës së ardhshme dëgjimore, e cila logjikshëm do të duhej t'i dedikohesh shpalljes së vendimit përfundimtar.

**19.5.** Lidhur me pretendimin e subjektit se vëzhguesja ndërkombëtare e çështjes gjatë seancës dëgjimore është shprehur se *subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer fshehje pasurie e as falsifikim dhe as veprime fiktive [...]*, qëndrim të cilin subjekti nuk e ka gjetur të pasqyruar në procesverbalin e seancës dëgjimore, Kolegji verifikoi përmbajtjen e regjistrimit audio të seancës dëgjimore, nga e cila rezultoi se ajo ka gjetur pasqyrim të plotë e të saktë në procesverbalin e mbajtur për zbardhjen e deklarimeve dhe veprimeve procedurale të kryera përgjatë seancës dëgjimore, duke e gjetur edhe këtë pretendim të subjektit të pambështetur në fakte.

**19.6.** Në konkluzion, në përmbledhje të të gjitha qëndrimeve të arsyetuara sa më sipër, lidhur me këtë shkak ankimi dhe që u referohet parregullsive të pretenduara në drejtim të zhvillimit të seancës dëgjimore, Kolegji arrin në përfundimin se këto pretendime të subjektit të rivlerësimit gjenden të pabazuara në prova dhe në ligj.

20. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit se: *Komisioni ka kryer një hetim të mangët, pasi: (a) hetimi është i paplotë pasi nuk u është referuar provave të paraqitura nga ana e subjektit të rivlerësimit; (b) hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm e i pavarur, por ai rezulton të jetë bazuar tërësisht te raporti i ILDKPKI-së; (c) Komisioni në asnjë moment nuk më ka bërë me dije se hetimi administrativ ndaj meje ka përfunduar, por më ka përcjellë vetëm rezultatet paraprake të hetimit; (ç) Komisioni nuk u shpreh në asnjë moment procedural lidhur me kërkesën për riçelje të hetimit administrativ dhe paraqitjen e provave të reja; Kolegji analizon si vijon.*

20.1. Në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ngre pretendimin se nga Komisioni, nuk janë konsideruar provat që ajo ka paraqitur gjatë hetimit administrativ. Lidhur me këtë pretendim, Kolegji konstaton se në përmbajtjen e vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, në pjesë të ndryshme të arsyetimit referohen/citohen<sup>4</sup> provat e paraqitura prej subjektit gjatë hetimit administrativ. Në këto kushte, Kolegji çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit nuk është i drejtë dhe i mbështetur në fakte. Fakti që Komisioni ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre nga ai i pretenduar prej subjektit, nuk e shndërron hetimin në të paplotë, por, përkundrazi, demonstroi një tagër diskrecionar të organeve të rivlerësimit për të vlerësuar brenda logjikës dhe çmimit të tyre, provat e paraqitura, në harmoni e krahasuar me të gjitha të dhënat e tjera që dalin nga hetimi. Në këto kushte, Kolegji, këtë pretendim të subjektit, e konsideron si të pabazuar dhe jo të drejtë.

20.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se *hetimi administrativ i kryer nga Komisioni nuk ka qenë i gjithanshëm dhe i pavarur, pasi rezulton të jetë bazuar tërësisht te raporti i ILDKPKI-së*, Kolegji analizon sa vijon.

20.3. Nga shqyrtimi i përmbajtjes së fashikullit të hetimit administrativ të krijuar nga Komisioni, konstatohet se ky organ gjatë hetimit administrativ për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka ndjekur të njëjtën procedurë të cilën e ka aplikuar edhe për subjektet e tjera. Më konkretisht, vetë Komisioni ka kërkuar për subjektin e rivlerësimit informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe zyrat e saj rajonale, nga bankat dhe entet financiare në vend, nga OSHEE dhe Ujësjellës Kanalizime etj. Në fashikullin e hetimit administrativ, në zbatim të parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, sigurisht gjendet i administruar edhe raporti i vlerësimit të pasurisë, i hartuar nga ILDKPKI-ja, në përputhje me parashikimet ligjore për detyrat dhe rolin që ky organ ndihmës ka në procesin e rivlerësimit.

20.4. Nga krahasimi i konkluzioneve të këtij raporti me ato të vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, konstatohet se konkluzionet e tyre nuk janë të njëjta në të gjitha vlerësimet e bëra, si edhe janë të pasuruara me rezultatet e arritura prej hetimit administrativ që vetë Komisioni ka zhvilluar. Në fashikull gjithashtu gjenden akte të ndryshme të administruara prej hetimit administrativ që ka zhvilluar vetë Komisioni e që nuk gjenden në dosjen e përpiluar prej ILDKPKI-së. Kolegji vlerëson se këto fakte tregojnë mjaftueshëm pavarësinë dhe autonominë

---

<sup>4</sup> Shih pjesën e vendimit tek e cila shprehet se:

“Subjekti ka depozituar mandatpagesën nr. (\*\*\*) , datë 23.5.2006, në shumën 8.000 euro, me përshkrimin “zvogëlim të pagesës së këstit të paguar më parë”, si dhe deklaratën noteriale nr. (\*\*\*) , datë 10.1.2020, të shoqërisë “[\*\*\*]” ShPK, nënshkruar nga shtetasi J. C., si përfaqësues i shoqërisë [...]”.

Lidhur me konstatimin e Komisionit se mungonte dokumentacioni justifikues për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave nga botimet e librave, ndër të tjera, subjekti ka parashtruar se i kishte deklaruar rregullisht si burim, ka depozituar kontratë bashkëpunimi për datat 9.1.2002 dhe 3.2.2003, si dhe 25 mandatpagesa për të ardhurat nga botimet e dy librave, sipas të cilave kishte përfituar shumën 999.000 lekë.

Por, trupi gjykues, situatën faktike e ka vlerësuar në analizë të provave të depozituara nga subjekti për të provuar veprimet e kryera në vitin 2006, për pagesat e kësaj pasurie dhe specifikisht dokumentacionin, fletë regjistri të spitalit, me anë të së cilës subjekti synon të provojë se veprimet financiare reciproke të tërheqjes së shumës prej 8.000 eurosh nga firma e ndërtimit, datë 23.5.2006 dhe ripagimi i saj në datën 24.7.2006, kanë qenë si rezultat i gjendjes shëndetësore të gjyshes së saj”.

e hetimit administrativ të kryer prej Komisionit, i cili ndonëse ka arritur në konkluzione që duken të njëjta në thelb me ato që ka arritur edhe ILDKPKI-ja, janë produkt i vlerësimit dhe analizës që vetë Komisioni ka bërë në përfundim të hetimit administrativ të zhvilluar prej tij. Për pasojë, referuar sa analizuar më sipër, ky pretendim i subjektit gjendet i pabazuar dhe i pambështetur në prova.

**20.5.** Për sa i përket pretendimit të subjektit se Komisioni në asnjë moment nuk i ka bërë me dije se hetimi administrativ ka përfunduar, por i ka përcjellë vetëm rezultatet paraprake të hetimit, Kolegji vlerëson se është një pretendim i paarsyeshëm dhe i pabazë. Referuar praktikës së deritanishme të zhvilluar nga Komisioni, pothuaj në të gjitha rastet e proceseve të tjera të rivlerësimit që u kanë përkitur subjekteve të tjera, Kolegji ka konstatuar të njëjtën mënyrë të Komisionit për t'u komunikuar subjekteve se procesi për ta ka përfunduar për sa i përket hetimit administrativ dhe se rezultatet janë ato që bëhen prezente në raportin e hetimeve paraprake. Në këtë moment, subjektet njihen me konkluzionet paraprake të hetimit, me çështjet për të cilat u kalohet barra e provës dhe procesi i rivlerësimit vijon më tej me dhënien e shpjegimeve prej tyre e paraqitjen e provave të reja, si edhe dëgjimin në seancë dëgjimore. Në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, nuk konstatohet asnjë hap procedural i kryer në kundërshtim/ndryshe me këtë praktikë të Komisionit e aq më pak ndonjë veprim i cili cenon në çfarëdo mënyre të drejtat e saj për një proces të rregullt ligjor. Në këto kushte, Kolegji çmon se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar.

**20.6.** Pretendimi tjetër i subjektit se *Komisioni nuk është shprehur në asnjë moment procedural lidhur me kërkesën e subjektit për riçelje të hetimit administrativ dhe paraqitjen e provave të reja*, gjendet gjithashtu i pabazuar, sipas asaj që rezulton nga aktet e administruara në fashikull. Nga aktet e administruara në fashikull, rezulton se me e-mail-in e datës 23.02.2020, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka përcjellë në Komision prapësimet e saj lidhur me rezultatet paraprake të hetimit, si dhe ka paraqitur me po të njëjtin dokument “Kërkesë për riçelje të hetimit dhe vlerësimit mbi bazën e tri kriterëve”.

Me e-mail-in e datës 26.02.2020, Komisioni i kthen përgjigje subjektit duke i bërë me dije se: *Referuar kërkesës për riçelje të hetimit edhe për dy kriteret e tjera, trupi gjykues qartëson se pas seancës dëgjimore dhe para marrjes së vendimit përfundimtar, do të vlerësoj të gjitha provat dhe shpjegimet e dhëna para dhe gjatë seancës dhe nëse ato do të vlerësohen se janë bindëse dhe të mjaftueshme për rihapjen e hetimit, atëherë trupi do të procedojë me marrjen e vendimit për rihapjen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.* Nga këto të dhëna, si dhe nga arsyetimi dhe qëndrimi i mbajtur në vendimin përfundimtar, rezulton se Komisioni ka vlerësuar se kërkesa e subjektit është e pambështetur dhe se Komisioni mund të merrte një vendim për zgjidhjen e çështjes edhe bazuar në vlerësimin e një kriteri, siç është ai i pasurisë, kompetencë të cilën, siç është arsyetuar dhe më lart, Komisioni e ka për shkak të parashikimit ligjor. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka pasur qartësi për qëndrimin e Komisionit se hapja ose e jo e hetimit për dy kriteret e tjera (kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale) do të varej nga vlerësimi përfundimtar që Komisioni do të bënte lidhur me provat e sjella prej saj për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe nga fakti nëse provat do të mund të përmbysnin konkluzionet paraprake të Komisionit, lidhur me këtë kriter, e të bëra me dije subjektit me kalimin e barrës së provës. Fakti që Komisioni nuk ka kundërshtuar qëndrimin e marrë në përfundim të hetimit administrativ, në raport me hetimin për dy kriteret e tjera, nuk mund të konsiderohet se ka munguar të vlerësojë kërkesën e subjektit për riçelje të hetimit për to, por se ka arritur në një konkluzion që e bënte të panevojshëm hetimin e mëtejshëm të çështjes, e cila mund të zgjidhej edhe vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Në këto kushte, Kolegji e gjen edhe këtë pretendim të subjektit të pambështetur në fakte e ligj.

## II. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë

21. Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit që kanë të bëjnë me kriterin e vlerësimit të pasurisë, Kolegji sheh me vend të nënvizojë faktin se kjo çështje, e parë në raport me personin e lidhur, bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, z. Ervin Karanxha, edhe ai subjekt rivlerësimi, do të ketë një vlerësim autonom e të pandikuar prej procesit të tij të rivlerësimit. Kolegji është gjendur në këtë rast në situatën kur Komisioni nuk ka analizuar rrethanat që lidhen me kriterin e vlerësimit të pasurisë për personin e lidhur, duke marrë një vendim për subjektin e rivlerësimit, mbështetur vetëm në të dhënat që lidhen me të dhe duke pranuar si të mirëqena deklaratimet e personit të lidhur për pasurinë e tij në këtë proces, deklarime të cilat, sipas Komisionit, do t'i nënshtrohen vlerësimit të një trupe tjetër gjyquese, e cila do të shqyrtojë procesin e rivlerësimit të personit të lidhur.
- Mbështetur mbi këtë qëndrim, Komisioni ka vlerësuar vetëm deklaratimet e subjektit të rivlerësimit dhe ka konkluduar vetëm mbi to. Gjithashtu, vetë subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur asnjë shkak ankimi lidhur me qëndrimin e Komisionit për pasuritë e krijuara prej personit të lidhur, duke lënë Kolegjin në këtë mënyrë jashtë juridiksionit rivlerësues e kontrollues për këto çështje. Për sa më lart, Kolegji, në respektim të kufijve të shqyrtimit të çështjes brenda shkaqeve të ankimit, sipas parashikimit të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile dhe parimit *no reformtio in peius*, nuk mori në shqyrtim çështje që lidhen me vlerësimin e pasurisë së personit të lidhur, duke mbajtur në konsideratë në këtë gjykim lidhur me to, qëndrimet që ka mbajtur Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi e të cilat nuk janë ankimuar prej subjektit të rivlerësimit.
22. Për pasurinë apartament banimi me sip. 57 m<sup>2</sup>, me adresë në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, subjekti pretendon se *konkluzioni i Komisionit është i pasaktë dhe i padrejtë, në drejtim të elementeve që kanë të bëjnë:*
1. Me vlerën e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, për të cilin subjekti pretendon se:
    - (i) *Konsiderimi prej Komisionit i mandatit të fundit, me vlerë 8.000 euro, si një vlerë shitesë në pagesën për blerjen e këtij apartamenti, duke e rritur në mënyrë fiktive shumë reale të paguar, prej 39.000 eurosh në 47.000 euro, është një qëndrim i padrejtë dhe jo i bazuar në prova, pasi vjen ndesh me shpjegimet e dhëna nga vetë subjekti lidhur me ato që përfaqëson kjo vlerë dhe me përshkrimin e mandatpagesës nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, si dhe me deklaratën noteriale nr. {\*\*\*}, datë 10.01.2020, të përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.*
    - (ii) *Mosdeklarimi në deklaratën “vetting”, i marrjes nga shoqëria të shumës 8.000 euro në vitin 2006, i cili po në këtë vit iu kthye shoqërisë nga subjekti, duhet konsideruar si një lapsus i cili nuk duhet të ndikojë në procesin e rivlerësimit, për sa kohë kjo lëvizje e fondeve ka ndodhur brenda vitit dhe faktohet me dokumente të kohës kur ka ndodhur ky veprim.*
    - (iii) *Komisioni ka bërë një vlerësim të gabuar të provave (dokumenteve hospitalore të gjyshes) që subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka paraqitur për të provuar nevojën që ka diktuar kërkesën e saj për të marrë nga shoqëria e ndërtimit fondet prej 8.000 eurosh nga shuma e paguar më parë prej saj.*
  2. Me analizimin e burimeve të ligjshme që kanë shërbyer për blerjen e apartamentin me sip. 57 m<sup>2</sup> në Tiranë, pasi:
    - (i) *Arsyetimi i Komisionit lidhur me destinimin e kredisë së marrë nga Alpha Bank, është i gabuar pasi subjekti pretendon se ka pasur detyrimin të deklarojë burimet e financimit të pasurisë dhe jo dokumentacion për të qartësuar veprimet pas disbursimit të kredisë për të provuar kalimin në llogarinë e shoqërisë së ndërtimit.*
    - (ii) *Për burimin e të ardhurave nga shitja e librave, subjekti pretendon se çdo aludim i Komisionit lidhur me këto të ardhura, është i pabazuar pasi ka provuar me dokumentacion provues ligjshmerinë e këtyre të ardhurave, në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.*

(iii) Subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit për huan e marrë nga kushërira e saj, znj. G. N., në vlerën 1.200.000 lekë, duke pretenduar se me shpjegimet e dhëna, si dhe me dokumentacionin e dorëzuar në Komision, ajo ka mundur të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

(iv) Subjekti pretendon se analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2004, në funksion të të ardhurave të ligjshme që ka pasur subjekti për blerjen e apartamentit 57 m<sup>2</sup>, është afektuar me të padrejtë edhe nga kostot e jetesës, të cilat subjekti i rivlerësimi, znj. Bernina Kondi, pretendon se duhet të jenë “0” lekë, pasi ajo ka jetuar me prindërit dhe këto kosto janë mbuluar prej tyre.

**22.1.** Për pasurinë apartament banimi me sip. 57 m<sup>2</sup>, e ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, në vendimin e Komisionit objekt shqyrtimi, është konkluduar se:

[...] Por, trupi gjykues, situatën faktike e ka vlerësuar në analizë të provave të depozituara nga subjekti për të provuar veprimet e kryera në vitin 2006, për pagesat e kësaj pasurie dhe specifikisht dokumentacionin, fletë regjistri të spitalit, me anë të së cilës subjekti synon të provojë se veprimet financiare reciproke, të tërheqjes së shumës prej 8.000 eurosh nga firma e ndërtimit, datë 23.5.2006, dhe ripagimi i saj në datën 24.7.2006, kanë qenë si rezultat i gjendjes shëndetësore të gjyshes së saj.

Pas verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga vetë subjekti, trupi gjykues ka konstatuar se fleta e regjistrit të spitalit daton më 18.9.2006, ndërkohë që shuma prej 8.000 eurosh ishte marrë më 23.5.2006 dhe ishte kthyer më 24.7.2006. Ky fakt bën të pabesueshme veprimet e kryera me këtë shumë për qëllime shëndetësore, si dhe shpjegimet e subjektit për vlerën reale të çmimit të paguar për këtë pasuri. Një argument tjetër logjik dhe i besueshëm do të kishte qenë depozitimi në ILDKPKI i të paktën mandatit të shumës prej 8.000 eurosh (i depozituar në Komision), në kohën kur subjekti është pyetur, ku pasqyrohet dhënia e shumës nga shoqëria ndërtimore për arsyet shëndetësore të pretenduara. Kjo do të përbënte provë për shkak se prej saj kishin ndodhur veprime përtej parashikimit kontraktor, në një kohë që në kontratë cilësohej se kësti i fundit i shlyerjes së pagesës së pasurisë ishte shuma 4.000 euro, dhe jo 8.000 euro, ndërsa subjekti ka depozituar vetëm mandatin e ripagimit të shumës. Në këto kushte:

✓ trupi gjykues, për efekt të këtij procesi, nuk i jep vlerë provuese fletës së regjistrit të spitalit, bashkëngjitur shkresës përcjellëse nr. (\*\*\*) prot., datë 20.2.2020, lëshuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Berat;

✓ trupi gjykues vlerëson se mosdeklarimi i pagesës prej 4.000 eurosh në deklaratën e vitit 2006, si kështu i fundit, sipas parashikimit kontraktor dhe për më tepër as edhe në deklaratën “vetting”, standard ku kërkohej plotësimi me saktësi dhe vërtetësi i pasurive dhe i veprimeve të kryera me to, i të drejtave dhe detyrimeve, bën të pabesueshme shpjegimet e subjektit në lidhje me vlerën reale të paguar për këtë pasuri.

Kjo situatë faktike, e ndërthurur me mosdeklarimet e pagesave reale në deklaratën periodike të vitit 2006 dhe në deklaratën “vetting”, e gërshetuar edhe me kontradiktoritetin e krijuar me deklarimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në shpjegimet e saj, mbi konstatimin e Komisionit se mandatet ishin dorëzuar vetëm gjatë hetimit administrativ, pasi kishte pasur bindjen se i rëndësishëm ishte pagimi i vlerës “de facto” të apartamentit dhe jo ruajtja e këtyre mandateve, ku nga hetimi u konstatua se subjekti nuk ka deklaruar, pikërisht në deklaratën periodike dhe atë “vetting”, pagesat reale, “de facto”, të kryera, çon trupin gjykues në konkluzionin se:

✓ mosdeklarimet e kësteve të paguara në vitet përkatëse dhe, për rrjedhojë, të vlerës reale të çmimit të paguar për këtë pasuri, e vendosin subjektin në kushtet e deklarimit të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e germës “a” të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, si dhe subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri sipas nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

22.2. Në analizë të shkakut të ankimit me të cilin subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me vlerën e apartamentin me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, Kolegji çmon se shpjegimet e dhëna nga subjekti në përgjigje të barrës së provës së kaluar prej Komisionit lidhur me këtë çështje, nuk janë bindëse e nuk mbështeten në prova që logjikshëm të provojnë faktet e pretenduara prej subjektit, duke konfirmuar në këtë mënyrë konkluzionin që ka arritur Komisioni lidhur me të. Nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara nga hetimi administrativ, konstatohet se subjekti, këtë pasuri e ka deklaruar si vijon.

(i) Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka deklaruar se pjesa e saj takuese për apartamentin 57 m<sup>2</sup> në Tiranë, është 100 % dhe se vlera totale e apartamentit është 39.000 euro; me burim krijimi nga kredia e marrë nga “Alpha Bank”, më datë 07.07.2005, në vlerën 2.500.000 lekë; kredi e marrë nga {\*\*\*} në datën 18.07.2006, në shumën 500.000 lekë; të ardhurat që dispononte familja e subjektit, si dhe të ardhurat e mbledhura nga shitja e librave të botuara prej subjektit.

(ii) Në DPV-në e vitit 2004, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrjeje, datë 21.09.2004, për ndërtimin e një apartamenti; vlera 39.000 euro; pagesa e kryer me këste; pagesa e këstit të parë 12.000 euro nga të ardhurat e familjes dhe nga të ardhurat e librave; është në ndërtim e sipër.*

(iii) Nga të dhënat e fashikullit, rezulton se përgjatë hetimit administrativ, Komisioni<sup>5</sup> ka kërkuar nga ILDKPKI-ja dërgimin e DVP-2003 të subjektit të rivlerësimit që mungonte në praktikën e përcjellë nga ky institucion në Komision, si dhe procesverbalet e mbajtura e çdo dokumentacion justifikues të paraqitur nga subjekti ndër vite në këtë institucion. Në përgjigje të kësaj kërkesë, ILDKPKI-ja<sup>6</sup> i përcjell Komisionit dokumentacionin e kërkuar, pjesë e të cilit janë edhe procesverbali i mbajtur ndërmjet subjektit dhe ILDKPKI-së më datë 06.03.2012 dhe më datë 13.02.2015, si dhe mandati me nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, i lëshuar prej shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, i cili tregon, sipas përshkrimit në të: “pagesë kësti i fundit, në vlerën 8.000 euro”. Në këtë procesverbal, subjekti ka deklaruar lidhur me burimet e financimit të apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup> në Tiranë se: *Në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave, nuk kemi fatura pasi këta libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme. Për sa u përket faturave për likuidimin e shtëpisë, disponoj vetëm mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, të pagesës së këstit të fundit prej 8000 eurosh.*

(iv) Në përgjigjet e pyetësorit nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2019, lidhur me pyetjen e Komisionit: *Në lidhje me apartamentin e blerë nga ana juaj në vitin 2004, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, me sip. 57 m<sup>2</sup>, me kontratën e sipërmarrjes së datës 21.09.2004, lutemi deklaroni nëse e keni shlyer totalisht dhe nëse jo sa është detyrimi i pashlyer. Gjithashtu depozitoni të gjitha pagesat e kryera për këtë apartament, subjekti ka shpjeguar se: *Pagesa e këtij apartamenti aktualisht është shlyer totalisht, ka filluar të realizohet kryesisht nga kursimet familjare dhe me kredinë e marrë në vitin 2005, në vlerën 2.500.000 lekë në Alpha Bank dhe në vijim deri në përfundimin e shlyerjes së të gjithë vlerës së tij, është likuiduar në mënyrë pjesore të vazhdueshme ndër vite, sipas parashikimeve në kontratën e sipërmarrjes së datës 21.09.2004 (bashkëngjitur dokumentacioni i pagesave të këtij apartamenti, mandat arkëtimet përkatëse, mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, dt. 21.09.2004; mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, dt.25.07.2005; mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, dt.20.07.2006).**

(v) Në pyetësorin nr. {\*\*\*}, të datës 07.01.2020, Komisioni i është drejtuar subjektit: *Ju keni depozituar një deklaratë noteriale me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 05.09.2019, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe tri mandate arkëtimi, përkatësisht me nr. {\*\*\*}, datë 21.09.2004, me të cilën i është paguar shuma 12.000 euro kësaj shoqërie; nr. {\*\*\*}, datë*

<sup>5</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 08.01.2020.

<sup>6</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.01.2020

25.07.2005, me të cilën është paguar shuma 23.000 euro; dhe nr. {\*\*\*}, datë 20.07.2006, me të cilën është paguar shuma 4.000 euro po kësaj shoqërie. Nga aktet e depozituara në dosjen e ILDKPKI-së, ju keni depozituar një mandat nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, sipas të cilit ju keni paguar shumën 8.000 euro, me përshkrimin : “Pagesë shtëpie 1+1, kësti i fundit”, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK. Lutemi saktësoni në mënyrë të detajuar mbi pagesat e kryera nga ana juaj lidhur me këtë pasuri. Lidhur me këtë pyetje të Komisionit, përgjatë hetimit administrativ, subjekti është përgjigjur si vijon:

Pasuria e blerë nga shoqëria “{\*\*\*}” me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., të datës 21.09.2004, është likuiduar totalisht në vlerën 39 (tridhjetë e nëntë) mijë euro. Mënyra e likuidimit të vlerës totale është realizuar sipas hapave të mëposhtëm.

- **Kësti i parë** është paguar në vlerën 12 (dymbëdhjetë) mijë euro ,referuar mandatarkëtimit përkatës që ju kam bashkangjitur bashkë me deklaratën noteriale të datës 5.9.2019, të cilën jua kam dërguar në pyetësorin e dytë.

- **Kësti i dytë** është paguar fillimisht në vlerën 23 (njëzetë e tre) mijë euro, referuar mandatit që ju kam dërguar bashkë me deklaratën noteriale të datës 5.9.2019, në pyetësorin e dytë.

Pas pagimit të këtij kësti, një nga pjesëtarët e familjes sime, gjyshja ime, pati një problem të rëndë shëndetësor, i cili kërkonte kurim të shpejtë jashtë vendit dhe një shpenzim monetar të cilin prindërit e mi për momentin nuk e përballonin dot. Për këtë arsye, pas kërkesës së babait tim, unë kam folur verbalisht me përfaqësuesin e firmës së ndërtimit “{\*\*\*}” për të më kthyer dorazi nga vlera e këstit të dytë të paguar, prej 23 mijë eurosh, një shumë prej 8 (tetë) mijë eurosh, që do e përdornim për këtë rast shëndetësor urgjent. Për këtë veprim, ju paraqes mandatpagesën përkatëse nr. {\*\*\*}, dt.23.5.2006, lëshuar nga përfaqësuesi i firmës që provon kthimin e shumës prej 8 mijë eurosh. Si pasojë e këtij veprimi, kësti i dytë mbeti i shlyer në vlerën 15 (pesëmbëdhjetë) mijë euro.

- **Kësti i tretë** është paguar në vlerën 4 (katër) mijë euro sipas mandatit të paraqitur bashkë me deklaratën noteriale të datës 5.9.2019, që ju kam dërguar në pyetësorin e dytë.

Pas pagimit të këstit të tretë, unë i detyrohesha firmës nga shuma totale 39 mijë euro e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes, shumën prej 8 mijë eurosh, e cila i është paguar firmës sipas mandatarkëtimit nr. {\*\*\*} të datës 24.7.2006. Kjo shumë prej 8 mijë eurosh më është kthyer mua nga babai im pasi gjendja e gjyshes sime u stabilizua pas trajtimit mjekësor në Shqipëri dhe nuk u përdor për kurimin e saj jashtë vendit. Pra, mandati i datës 24.7.2006, mbyll detyrimet e mia ndaj shoqërisë së ndërtimit, duke u likuiduar vlera totale prej 39 mijë eurosh, për apartamentin në fjalë.

Në lidhje me sa deklarova më sipër, do t’ju paraqes dhe deklaratën noteriale me nr. {\*\*\*} kol., dhe nr. {\*\*\*} rep., të datës 10.1.2020, bashkë me deklaratën e mëparshme të datës 5.9.2019, si dhe mandatet përkatëse për çdo pagesë të kryer në lidhje me këtë pasuri.

**22.3.** Përveç sa më sipër, Kolegji konstaton se në fashikullin e hetimit administrativ, gjenden të administruara deklaratat noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë **05.09.2019** dhe nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë **10.01.2020**, të lëshuara nga z. **J. C.** me cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, sipas prokurës së përgjithshme me nr. {\*\*\*} rep., e nr. {\*\*\*} kol., datë 08.12.201.

Në deklaratën noteriale të datës **05.09.2019**, z. J. C. deklaroi se vlera e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, ne rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, është 39.000 euro dhe kjo vlerë është paguar nga porositësja Bernina Kondi me këste:

- kësti i parë, në shumën 12 000 euro, është paguar kur është lidhur kontrata e porosisë, në vitin 2004;
- kësti i dytë, në shumën 23.000 euro, është likuiduar brenda vitit 2005;
- kësti i fundit, me vlerës 4.000 euro, është likuiduar në vitin 2006, kohë kur janë dorëzuar edhe çelësat e këtij apartamenti.



Në deklaratën tjetër noteriale të datës **10.01.2020**, sërish përfaqësuesi i kompanisë, z. J. C., deklaroi se: Në sqarim të deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., dhe nr. {\*\*\*} kol., e datës 05.09.2019, në lidhje me pagesat e likuiduara nga znj. Bernina Kondi për apartamentin e porositur, deklaroi se znj. Kondi, këstin e dytë, prej 23.000 eurosh, të likuidimit të vlerës së apartamentit, e ka likuiduar brenda vitit 2005, po nga kjo shumë për arsye shëndetësore të një pjesëtari të familjes, ajo ka kërkuar t'i kthehej shuma prej 8000 eurosh, të cilën do ta likuidojë në një periudhë të mëvonshme. Deklaroi se znj. B. Kondi, vlerën prej 8000 eurosh, që përfaqëson edhe likuidimin e këstit të fundit, e ka shlyer me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, që i bashkëlidhet kësaj deklaratë. Deklaroi gjithashtu se nga znj. B. Kondi, është likuiduar vlera e plotë e porositjes së apartamentit brenda vitit 2006. Bashkëlidhur deklaratës noteriale të datës **10.01.2020**, deklaruesi, z. J. C., ka paraqitur jo më 3 mandate, por 4 mandatarkëtime, pjesë e të cilave është edhe mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë **23.05.2006**, me përmbajtjen si vijon: Arkëtohet nga Firma “{\*\*\*}” ShPK shuma 8000 euro për Znj. Bernina Kondi; shënim zvogëlim i pagesës së këstit të paguar më parë. Mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, është përcjellë në Komision nga subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në mbështetje të sqarimit që ajo ka dhënë me pyetësin nr. {\*\*\*}<sup>7</sup>, lidhur me pagesat për vlerën e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup> në Tiranë. Ky mandat konstatohet të mos jetë paraqitur si dokument në ILDKPKI e as në dokumentet mbështetëse të deklaratës *vetting*, por për herë të parë paraqitet nga subjekti përgjatë shpjegimeve të pyetësit nr. {\*\*\*}, pasi Komisioni ka evidentuar ekzistencën e mandatis nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006 dhe kontradiktën që ai prodhonte me mandatat e paraqitura prej subjektit në përgjigje të pyetësit nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2019.

**22.4.** Në ankim, si dhe përgjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi se vlera e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, është 39.000 euro dhe mban të njëjtin qëndrim lidhur me atë që përfaqëson mandati nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, i cili tregon për pagesë kësti në vlerën 8.000 euro. Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, kundërshtoi konkluzionin e Komisionit në drejtim të vlerës së apartamentit, duke pretenduar se nuk gjendet ne kushtet e mosdeklarimit të saktë të vlerës reale të pasurisë, pasi të gjitha provat e paraqitura, të pakundërshtueshme për falsitet apo pavlefshmëri, tregojnë qartazi se, që nga viti 2004 e deri në deklaratën *vetting*, vlera reale e apartamentit që ajo ka paguar, është ajo që figuron edhe në kontratën e sipërmarrjes me firmën e ndërtimit, prej 39.000 eurosh. Në ankim, ashtu si edhe përgjatë hetimit administrativ, subjekti sqaroi se mandati i datës 24.07.2006 mbyll detyrimet e saj ndaj shoqërisë së ndërtimit për apartamentin 57 m<sup>2</sup>, duke u likuiduar kështu vlera totale prej 39.000 eurosh. Subjekti ka pretenduar se fakti që nuk e ka deklaruar këtë veprim në deklaratën *vetting* dhe as në deklaratën e vitit 2006, ka ndodhur sepse tërheqja e shumës prej 8.000 eurosh nga firma e ndërtimit në datën 23.05.2006 dhe ripagimi i saj në datën 24.07.2006, kanë ndodhur si veprime brenda të njëjtit vit financiar dhe se ajo nuk e ka deklaruar se ka pasur bindjen që efekti financiar është në vlerën “0”, pra nuk ka ndodhur ky zvogëlim përtej afatit njëvjeçar për të cilin i lind detyrimi ta deklarojë. Gjithashtu, subjekti pretendon se në rastin e procesit të saj të rivlerësimit, mosdeklarimi i mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, për shumën 8000 euro, është konsideruar nga Komisioni edhe në kundërshtim me standardet e vendosura me vendimet e dhëna prej Komisionit që kanë marrë formë të prerë, të cilat ka konsideruar si pakujdesi, mosdeklarime të pasurisë në deklaratën *vetting* apo në DVP.

**22.5.** Kolegji vëren se arsyet që subjekti ka pretenduar se kanë shërbyer për të marrë mbrojtje në maj të vitit 2006, shumën prej 8.000 eurosh nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, kanë të bëjnë me

---

<sup>7</sup> Në përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti ka shpjeguar: “[...] Pas pagimit të këstit të tretë, unë i detyrohesha firmës nga shuma totale, 39 mijë euro e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes, shumën prej 8 mijë eurosh, e cila i është paguar firmës sipas mandatarkëtimit nr. {\*\*\*} të datës 24.7.2006. Kjo shumë prej 8 mijë eurosh, më është kthyer mua nga babai im, pasi gjendja e gjyshes sime u stabilizua pas trajtimit mjekësor në Shqipëri dhe nuk u përdor për kurimin e saj jashtë vendit. Pra, mandati i datës 24.7.2006, mbyll detyrimet e mia ndaj shoqërisë së ndërtimit, duke u likuiduar vlera totale prej 39 mijë eurosh, për apartamentin në fjalë”.

një emergjencë shëndetësore të gjyshes së saj. Me ankimin, subjekti kundërshton qëndrimin e Komisionit lidhur me vlerësimin që ka bërë mbi dokumentacionin e paraqitur prej saj për të provuar gjendjen e shëndetësore të gjyshes, duke pretenduar se gjyshja ka qenë e sëmurë kronike dhe dokumentacioni spitalor është paraqitur në Komision për të faktuar gjendjen e saj shëndetësore dhe se data që ky akt mban nuk tregon momentin kur ajo është sëmurë, por evidenton një nga rastet e shumta kur ajo ka pasur nevojë për ndihmë mjekësore, e cila më shpesh i ofrohej në banesë, nga mjeku i familjes.

**22.6.** Në analizë të gjitha sa përshkruar më sipër lidhur me vlerën e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, Kolegji vëren se në një mbledhje aritmetike të shumave të mandatpagesave që vetë subjekti ka paraqitur për blerjen e kësaj pasurie, rezulton që vlera e paguar për të, të jetë 47.000 euro, dhe jo 39.000 euro, siç ka deklaruar subjekti. Mungesa e deklarimit të mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, me përshkrimin: “*Zvogëlim të pagesës së këstit të paguar*”, me vlerë 8.000 euro, me përfitues subjektin e rivlerësimit dhe *pagues shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK*, si gjatë kontrollit në ILDKPKI në vitet 2012 e 2015, por edhe në deklaratën “vetting”, dhe paraqitja e tij vetëm me përgjigjet e pyetësorit nr. {\*\*\*}, e analizuar edhe në raport me përmbajtjen e mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, me përshkrimin: *Pagesë kësti i fundit, në vlerën 8.000 euro*, janë elemente të cilat iu nënshtruan vlerësimit për të arritur në një konkluzion për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

**22.7.** Kolegji mbajti në konsideratë disa rrethana faktike për t’i dhënë përgjigje shkakut të ankimit të ngritur prej subjektit, që kundërshtonte qëndrimin e Komisionit rreth pagesës së shumës prej 8000 eurosh, si pjesë e çmimit të blerjes së apartamentit me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë.

**22.8.** *Së pari*, Kolegji konstaton se subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram rreth këtij veprimi financiar të kryer me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK as në deklaratën *vetting*, dhe as në deklaratat periodike. Subjekti nuk ka shpjeguar rreth këtij transaksioni as në deklarimet e dhëna në ILDKPKI në vitet 2012 e 2015, kur është ftuar të japë shpjegime për pagesën e detyrimit shoqërisë që ka ndërtuar apartamentin objekt verifikimi dhe as ka shoqëruar me ndonjë shpjegim të tillë këtë mandat në kohën që e ka depozituar për herë të parë në ILDKPKI. Në të njëjtën linjë, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, nuk ka dhënë një shpjegim për çfarë përfaqësonte ky mandat edhe gjatë hetimit administrativ, madje as kur ka depozituar tri mandatet që, sipas saj, përfaqësojnë pagesat për vlerën e apartamentit, në shumën prej 39.000 eurosh, në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*} të drejtuar prej Komisionit. Madje ajo ka paraqitur një skemë të ndryshme të pagimit të kësteve, e mbështetur edhe nga z. J. C., me deklarimet e tij në deklaratën noteriale të datës 05.09.2019. Subjekti ka dhënë një shpjegim për këtë mandat vetëm pasi Komisioni e ka evidentuar atë si një këst që rezultonte të ishte paguar, por që kishte mospërputhje me pagesat e tjera, në raport me vlerën e apartamentit. Vetëm pas këtij momenti, subjekti jep një shpjegim për pagesën e këstit si një pagesë e kthyer mbrapsht, shpjegim i cili mbështet edhe nga z. J. C. me deklaratën e dytë noteriale të datës 10.01.2020.

**22.9.** *Së dyti*, nuk duket bindës pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, se ajo nuk e kishte deklaruar këtë mandat apo pagesën e bërë nëpërmjet tij në DPV-në e vitit 2006, duke qenë se ishte një transaksion që nuk kishte ndryshuar gjendjen e saj të pasurisë, për sa kohë që subjekti ka qenë në dijeni dhe në zotërim të këtij mandati të paktën që prej vitit 2012, kur e ka dorëzuar për herë të parë në ILDKPKI, rrethanë që do të duhej normalisht të kishte tërhequr vëmendjen e saj drejt sqarimit të informacionit që ajo kishte, qoftë në deklarimet në ILDKPKI, qoftë në deklaratat e mëpasshme periodike apo në deklaratën *vetting*, por në pikë fundore, në momentin kur ajo u pyet nga Komisioni për mënyrën e pagesës së vlerës së apartamentit në pyetësorin nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2019.

**22.10.** *Së treti*, narrativa e ngjarjeve që, sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, kanë provokuar marrjen mbrapsht të kësaj shume prej shoqërisë e që lidhen me gjendjen

shëndetësore të gjyshes së saj, është jobindëse, sepse: i) nuk përkon me asnjë dokument që tregon qoftë edhe nevojën për pagimin e një shume të tillë për trajtimin shëndetësor të gjyshes; ii) subjekti nuk identifikon asnjë diagnozë specifike e cila kërkon mjekim të dedikuar; iii) dokumentacioni spitalor që ajo ka paraqitur gjatë hetimit administrativ për të provuar gjendjen shëndetësore të gjyshes, daton larg në kohë, shtator 2006, pas nevojës së pretenduar prej saj për mjekim, madje edhe pasi ajo ia kishte kthyer mbrapsht shoqërisë së ndërtimit paratë e mara në formë huaje për periudhën maj-korrik 2006; iv) nuk duket e logjikshme që në mbështetje të familjes për kurimin e familjarit të afërm, të kërkohej mbështetje nga një shoqëri ndërtimi, me të cilën nuk deklarohet se ka pasur ndonjë marrëdhënie të posaçme që të justifikojë në pikëpamjen logjike këtë ndihmë.

**22.11.** *Së katërtri*, deklaratat noteriale të përpiluara prej z. J. C., konstatohet se paraqesin disa elemente që vënë në dyshim pozitën e tij në raport me shoqërinë dhe vërtetësinë e deklarimeve të tij, pasi: i) rezulton një status shumë i paqartë i tij në raport me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, duke qenë se vepron me anë të një prokure të përgjithshme që daton e përpiluar në vitin 2011 dhe ka të përcaktuar një numër tagrash përfaqësimi që lidhen me shitjen dhe blerjen e apartamenteve të ndërtuara nga shoqëria, por jo tagra përfaqësimi të shoqërisë në raport me të tretët në çdo marrëdhënie që ajo vendoset; ii) logjikshëm ka dyshime për sa i përket fuqisë ligjore të saj, nëse kjo prokurë është ende në fuqi apo janë revokuar këto tagra përfaqësimi, në kushtet kur shoqëria është me status “Pezulluar” në QKB dhe prokura është hartuar në vitin 2011; iii) nuk evidentohen rrethanat në të cilat ky dokumentacion është disponuar prej z. C.; iv) nuk ka asnjë shpjegim prej tij pse ky dokumentacion nuk është bërë prezent që në deklaratimet e tij të para.

**22.12.** Në përfundim, ndonëse Kolegji konstatoi se konkluzioni i Komisionit lidhur me vlerën e pasurisë nuk kishte gjetur pasqyrim në analizën financiare për verifikimin e burimeve të ligjshme për blerjen e tij, konkluzioni me natyrë ligjore i këtij organi, gjen mbështetje dhe kualifikohet në kuadër të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe detyrimit që përcakton kjo dispozitë për subjektet e rivlerësimit, të deklarojnë saktë e me vërtetësi pasuritë në pronësi të tyre, vlerat përkatëse, si edhe të justifikojnë burimet e ligjshme për krijimin e tyre. Kolegji vlerëson se me të drejtë Komisioni, duke vlerësuar çdo të dhënë që vjen nga burime të besueshme e në pajtueshmëri me provat e tjera e duke bërë në çdo rast një vlerësim të tyre sipas bindjes së brendshme, ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, nuk provoi bindshëm versionin e saj për pagesën e shumës prej 8000 eurosh, si pjesë e vlerës prej 39.000 eurosh, për blerjen e apartamentit, duke u konfirmuar edhe prej Kolegjit i njëjti përfundim.

**22.13.** Përfundimisht, Kolegji e konsideroi të drejtë qëndrimin e Komisionit *se subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë*. Kolegji vlerësoi se shpjegimet e dhëna nga subjekti përgjatë hetimit administrativ, si dhe në ankim për transaksionin e kryer për pagesën e kështit të fundit, prej 8.000 eurosh, shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në vitin 2006, nuk janë të mbështetura në të dhënat që rezultojnë nga aktet e tjera të administruara në fashikull dhe as janë në koherencë me deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në deklaratën periodike të pasurisë të vitit 2006, ato të dhëna para ILDKPKI-së në vitin 2012 dhe as me ato të dhëna prej saj në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}, të drejtuar nga Komisioni. Këto shpjegime nuk gjejnë mbështetje as në aktet shkresore që janë paraqitur prej subjektit e që dëshmojnë problemet shëndetësore të familjarit të saj, të cilat datojnë në një kohë të ndryshme nga momenti kur subjekti pretendon se është nevojitur marrja e kësaj shume prej shoqërisë. Në analizë të të gjitha të dhënave, Kolegji arriti në përfundimin se konkluzioni i Komisionit lidhur me mosjustifikimin bindshëm të arsyeve për pagimin e këtij kësti, mbetet i pandryshuar prej pretendimeve të subjektit në ankim. Për pasojë, është i drejtë përfundimi se subjekti ka deklaruar në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.

23. Në lidhje me shkaqet e ankimit që lidhen me burimet e financimit të pasurisë apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, Kolegji analizon sa vijon.

23.1. Në deklaratën *vetting*, si burime financimi për apartamentin me sip. 57 m<sup>2</sup>, subjekti ka deklaruar:

- kredia e marrë në Bankën Alpha, më datë 07.07.2005, me vlerë 2.500.000 lekë;
- kredia e marrë nga {\*\*\*}, më datë 18.07.2006, me vlerë 500.000 lekë;
- të ardhurat e familjes (pa specifikuar vlerë);
- të ardhurat nga shitja e librave të botuar nga subjekti (pa specifikuar vlerë).

23.2. Kolegji konstaton se Komisioni ka marrë në analizë të gjitha burimet e financimet e kësaj pasurie, të deklaruara prej subjektit në deklaratën *vetting* dhe rezultojnë që kredia e marrë në Alpha Bank, është analizuar nga Komisioni në drejtim të provimit të destinacionit të saj për të financuar këtë pasuri, si dhe në drejtim të burimeve financiare që kanë shërbyer për shlyerjen e saj, konkretisht të përdorimit të huas së marrë nga huadhënësja G. N., për këtë qëllim.

23.3. Në lidhje me destinimin e kredisë së marrë nga subjekti në Alpha Bank, në rezultatet e hetimit paraprak, Komisioni ka konstatuar se: *Mungonte dokumentacioni justifikues bankar mbi destinacionin e dy transaksioneve të kryera në llogarinë e kredisë në Alpha Bank, në datën 7.7.2005, në shumën 1.230.000 lekë dhe në datën 13.7.2005, po në shumën 1.230.000 lekë, si dhe dokumentacioni justifikues bankar mbi tërheqjen e kredisë në shumën prej 2.500.000 lekësh në po këtë bankë.* Për këtë konstatim të Komisionit, me shpjegimet në përgjigje të rezultateve të hetimit paraprak, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka shpjeguar mosdakordësinë e saj, duke pretenduar se të gjitha veprimet e kryera, si dhe dokumentacioni i paraqitur prej saj tregojnë qartë që çdo veprim ka qenë në përputhje të plotë me realizimin e kontratës së sipërmarrjes, dhe se huaja, sipas parashikimeve të kontratës së lidhur me Alpha Bank, ishte lidhur me qëllimin e vetëm për blerje apartamenti. Shuma totale e kredisë prej 2.500.000 lekësh, ishte tërhequr në dy këste, pasi banka nuk mund të lëvronte gjithë shumën e kredisë në një ditë dhe nga Komisioni ishte kuptuar gabim si veprim bankar, duke pretenduar se ajo nuk përfaqëson tërheqje të ndonjë shume tjetër, përveç shumës së kredisë.

23.4. Pasi është njohur me shpjegimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me kredinë e marrë në Alpha Bank, Komisioni në vendim ka arsyetuar se:

- *Subjekti nuk arriti të provojë destinacionin e kredisë së përfutur, në shumën 2.500.000 lekë, në Alpha Bank dhe, për pasojë, nuk arriti të shpjegojë bindshëm njërin prej burimeve të kësaj pasurie (deklaruar me këtë kredi), në kundërshtim me pikën 3 të nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.*
- *Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, në kundërshtim me parashikimin e germës "a" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.*

23.5. Subjekti i rivlerësimit në ankim, lidhur me këtë qëndrim të Komisionit, pretendon se i është kërkuar me rezultatet e hetimit, dokumentacion justifikues bankar dhe se nuk i është kërkuar dokumentacion apo ndonjë provë për të qartësuar veprimet bankare të kryera pas disbursimit të kredisë, për të identifikuar pritësin e dy transfertave, tërheqjen e tyre dhe kalimin në llogarinë bankare të shoqërisë. Sipas subjektit, Alpha Bank i ka kthyer përgjigje me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 19.02.2019, se kjo bankë nuk i disponon më në sistem veprimet e kryera para vitit 2009, pasi ndryshimi i sistemit informatik në bankë, ka sjellë që platformat e mëparshme të jenë të paaksesueshme. Me këtë shkresë, banka i ka përcjellë Komisionit vetëm dokumentet për pagimin e kësteve pas vitit 2009, deri në shlyerjen e plotë të kredisë. *Hetimi i Komisionit ka qenë i paplotë pasi vetë ai duhet t'i drejtohej bankës dhe të merrte informacion sa më të plotë në lidhje me këto transaksione. Meqenëse ka kaluar një kohë shumë e gjatë, për gati 17 vite, subjekti i rivlerësimit sqaron se këto dy transaksione u*

janë bërë dy agjencive të shkëmbimit valutor, por që vetëm për njërin mban mend emrin e subjektit tregtar (“{\*\*\*}”, me administrator A. Y.), i cili ende vazhdon të ushtrojë aktivitet në qendër të qytetit të Beratit.

**23.6.** Lidhur me këtë shkak ankimi, Kolegji, nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit, konstaton sa vijon.

- *Së pari*, ndonëse Komisioni ka mbajtur qëndrimin se subjekti nuk provon bindshëm destinacionin e saj, shumën prej 2.500.000 lekësh, të përfituar nga kjo kredi, e ka përfshirë në tabelën e analizës financiare të pasqyruar në vendim, si një nga burimet e financimit të apartamentit 57 m<sup>2</sup>, duke krijuar konfuzion dhe paqartësi për subjektin, por edhe për organet kontrolluese lidhur me qëndrimin që ka mbajtur Komisioni në raport me kredinë e Bankës Alpha, nëse ky element i analizës ekonomike ka shërbyer ose jo si shkak shkarkimi.
- *Së dyti*, kredia e marrë prej subjektit tek Banka Alpha, është një kredi tregtare e cila, ashtu siç është parashikuar në marrëveshjen e kredisë, është deklaruar nga subjekti ne DVP-2005 dhe në deklaratën *vetting*, se ka shkuar për financimin e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë.
- *Së treti*, nga analizimi i rezultateve të hetimit administrativ, konstatohet se në lidhje me këtë kredi, Komisioni i ka bërë me dije subjektit se: *Nga dokumentacioni i përcjellë, Komisioni ka konstatuar se nga llogaria e kredisë, subjekti ka kryer dy transaksione, përkatësisht më datë 07.07.2005, në shumën 1.230.000 lekë dhe më datë 13.07.2005, po në shumën 1.230.000 lekë, por nuk identifikohet përshkrimi i këtyre transfertave dhe as përfituesi i tyre.* Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, me përgjigjet e saj mbi rezultatet e hetimit, i bën me dije Komisionit se: *kredia e përfituar në Alpha Bank, është tërhequr në dy këste, brenda një afati pesëditor dhe është kryer për një javë pagesa e këstit të dytë, 23 mijë euro, pasi firma e ndërtimit kërkonte pagesën e kësaj shumë për vitin 2005. Nuk jam dakord me konstatimet që ka bërë Komisioni mbi qëllimin e përdorimit të kësaj kredie, pasi të gjitha veprimet e mia dhe dokumentacioni që unë kam paraqitur, tregojnë qartë që çdo veprim ka qenë në përputhje të plotë me realizimin e kontratës së sipërmarrjes, konform marrëveshjes shpesh të financimit nr. {\*\*\*} rep., dhe me nr. {\*\*\*} kol., lidhur në datën 28.06.2005, e cila përcakton se “Huaja jepet me afat prej 15 vjetësh, që fillon nga dita e parë e disbursimit, me shlyerje me këste tremujore, me qëllim të vetëm për blerje apartamenti.*
- *Së katërti*, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në ankim, përveçse shpjegon se prej saj kjo kredi është transferuar te subjekte që këmbejnë valutë, me qëllim konvertimin në euro, dhe i identifikon ata (për të cilët, përgjatë hetimit administrativ, Alpha Bank ka përcjellë informacionin se, për shkak të ndryshimit të sistemeve, nuk disponon të dhënat e transfertave bankare), ngre edhe pretendimin se referuar legjislacionit të kohës (ligjit nr. 9049/2003), nuk ka pasur detyrim të provojë/faktojë me dokumentacion kalimin direkt të fondeve të kredisë te kompania e ndërtimit, pasi detyrimi i saj i vetëm ka qenë të provojë burimet e ligjshme të financimit të pasurive.

**23.7.** Në analizë të sa parashtruar më sipër, Kolegji, duke konsideruar: **(i)** qëndrimin e Komisionit që në analizën ekonomike për të cilën i ka kaluar subjektit barrën e provës, ka të përfshirë si burim për financimin e apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, të ardhurat e siguruar nga kredia në Bankën Alpha; **(ii)** faktin që kredia e marrë prej subjektit nga kjo bankë në vitin 2005, ishte një kredi tregtare e destinuar, sipas objektit të marrëveshjes, për financimin e një apartamenti banimi; **(iii)** parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe ato të ligjit nr. 9049/2003, të cilat përcaktojnë detyrimin e subjekteve deklaruese që të provojnë burimet e ligjshme të financimit të pasurive të tyre dhe jo detyrimisht një mekanizëm të paracaktuar për provueshmërinë e realizimit të transaksioneve bankare në funksion të këtij qëllimi; **(iv)** përputhjen e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting* me ato që ka bërë në DPV-2005, lidhur me identifikimin e këtij burimi financimi; **(v)** mosevidentimin e ndonjë dyshimi të ngritur nga hetimi administrativ që kjo kredi të jetë përdorur për financimin e ndonjë pasurie apo përballimin e ndonjë shpenzimi tjetër të subjektit të rivlerësimit; **(vi)**

mosasocimin e këtij konkluzioni me ndonjë nga rastet që sipas nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, të çojnë në konkluzionin se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm, çmon se qëndrimi i Komisionit se subjekti nuk provon bindshëm destinacionin e kësaj kredie, është një konkluzion pa relevancë në vendimmarrje, që duket se kapërcen përcaktimet ligjore për shkeljet e ligjit të cilat mund të shkaktojnë për subjektet e rivlerësimit, vendosjen e një mase disiplinore.

Për pasojë, Kolegji e gjen të drejtë shkakun e ankimit të ngritur në këtë drejtim nga subjekti i rivlerësimit.

**23.8.** Lidhur me analizimin e burimit të të ardhurave nga shitja e librave, në vlerën prej 1.000.000 lekësh, Kolegji analizon sa në vijim.

**23.9.** Në vendimin e Komisionit, lidhur me të ardhurat që subjekti ka deklaruar në deklaratën vetting, si të përfituara nga shitja e librave, është konkluduar sa vijon.

*Gjithashtu, trupi gjykues në këtë çështje vlerëson edhe faktin se të ardhurat janë krijuar përpara se subjekti të kishte nisur ushtrimin e funksionit të saj si gjyqtare, pra, përpara se të bëhej subjekt deklarimi. Në këto kushte, pavarësisht se nga njëra anë mbahen në konsideratë rrethana të tilla, që lidhen me të ardhura të krijuara përpara detyrës, në anën tjetër është konkluduar se në balancën negative të konstatuar në vitin 2004, në shumën 94.153 lekë, nuk ka pasur rol vendimtar mospërfshirja e kësaj shume, megjithëse e kontestuar nga subjekti.*

*Pra, ndërsa trupi gjykues vlerësoi nëpërmjet kësaj analize ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, çmon se në raport edhe me balancën negative, përfshirja e tyre thjesht dhe vetëm eliminon shumën prej 94.153 lekësh dhe, për pasojë, subjekti, nga rillogaritjet financiare për vitin 2004, gjendet në balancë pozitive.*

*Në kushte të tilla, trupi gjykues çmon se:*

- *Mospërputhjet e deklaramit të subjektit se në lidhje me të ardhurat e realizuara nga shitja e librave, nuk ka fatura, pasi këta libra janë shitur në librari të ndryshme dhe në sasi të ndryshme, me veprimin e kryer gjatë hetimit, ku depozitoi 25 mandatpagesa, ndikojnë në vlerësimin etik të subjektit të rivlerësimit.*
- *Lidhur me ligjshmërinë e krijimit të kësaj shume, nuk konstatohen problematika.*

**23.10.** Lidhur me këtë situatë, pavarësisht se në ankim, subjekti pretendon se çdo aludim i Komisionit lidhur me këto të ardhura, është i pabazuar pasi ka provuar me dokumentacion provues ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji konstaton se ky pretendim është i panevojshëm të analizohet, për sa kohë që Komisioni ka njohur në përfundim ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, ndonëse ato nuk kanë rezultuar me ndonjë impakt të ndjeshëm financiar në analizën e bërë për vitin 2004. Për këtë arsye, Kolegji e sheh pa relevancë trajtimin e këtij shkak ankimi në këtë drejtim, për sa kohë nuk ka afektuar negativisht marrjen e vendimit objekt shqyrtimi.

**23.11.** Ndërsa lidhur me qëndrimin e vendimit të Komisionit në drejtim të vlerësimit të sjelljes së subjektit për sa i përket qëndrimit të ndryshëm lidhur me disponimin e faturave tatimore që provonin shitjen e librave dhe përfitimin e të ardhurave të deklaruara, e për të cilën Komisioni ka një konkluzion deklarativ lidhur me vlerësimin etik të subjektit, Kolegji analizon si më sipër në raport me kuptimin për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit duket se Komisioni ka kualifikuar këtë vlerësim, ndonëse jo në mënyrë të qartë.

**23.12.** Në kushtet kur, referuar vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, konstatohet se masa disiplinore për shkarkimin e subjektit nga detyra, është bërë vetëm mbi konkluzionet e arritura nga ky Komision mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë, konkluzionet e kësaj natyre (që lidhen me etikën), pa marrë një qëndrim për thelbin e tyre, të cilat do të duhej të ishin vlerësuar brenda kriterit të vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit, sipas përcaktimeve të nenit 75 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dhe më tej mund të ishin pjesë e vlerësimit të përgjithshëm të tri kriterëve, sipas

parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, elemente që do të mund të çonin në aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, dalin jashtë kufijve të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Kolegji vlerëson si të pambështetur ligjërish konkluzionin e arritur nga Komisioni lidhur me vlerësimin etik e të përdorur si një prej shkaqeve të shkarkimit të subjektit të rivlerësimit, duke e gjendur të drejtë pretendimin e subjektit lidhur me këtë konkluzion.

**23.13.** Lidhur me të ardhurat e siguruar nga huaja e marrë nga huadhënësja G. N., Kolegji konstaton dhe analizon si në vijim.

Në ankim, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, kundërshton konkluzionin e Komisionit lidhur me huan e marrë nga kushërira e saj, znj. G. N., në vlerën 1.200.000 lekë, duke pretenduar se me shpjegimet e dhëna, si dhe me dokumentacionin e dorëzuar në Komision, ajo ka mundur të provojë ligjshmërinë e këtyre të ardhurave në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

**23.14.** Në vendimin e Komisionit, lidhur me huan e marrë prej subjektit nga kushërira e saj, znj. G. N., është konkluduar se:

○ *Bazuar në pikën 3 të nenit D të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 1.200.000 lekë, deklaruar si hua e marrë shtetas G. N. dhe, për pasojë, kjo shumë nuk mund të përfshihet në analizën financiare të vitit 2010.*

**23.15.** Në analizë të deklarimeve të subjektit për këtë hua, rezulton se prej saj në DVP-në e vitit 2010, është deklaruar huaja e marrë në shumën 1.200.000 lekë, nga shtetasja G. N., e cila është vajza e tezes së subjektit, hua që është përdorur për shlyerjen e parakohshme të pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga subjekti në Bankën Alpha. Në këto kushte, Kolegji konstaton se me të drejtë, në kuptim të përcaktimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni e ka konsideruar huadhënësen G. N. si person tjetër të lidhur dhe, në këtë kuptim, subjekti ka detyrimin për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të marra hua prej saj nga huadhënësja.

**23.16.** Nga aktet e administruara në fashikullin e hetimit administrativ, konstatohet se subjekti i rivlerësimit përgjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e pyetësorit nr. {\*\*\*}, te të cilat i është kërkuar të shpjegojë burimin e ligjshëm të krijimit të shumës së marrë hua nga znj. G. N., ka paraqitur si provë një deklaratë noteriale nr. {\*\*\*}, datë 09.09.2019, në të cilën huadhënësja G. N. deklaron se ka marrë hua shumën 10.000 euro nga shtetasi A. G., më datë 22.08.2009, me afat likuidimi brenda datës 22.08.2024, me qëllim hapjen e një aktiviteti privat, parukeri, të cilin ende nuk ka mundur ta hapë deri sot.

**23.17.** Për sa më sipër Kolegji evidenton se:

i) Ligji nr. 84/2016, si dhe ligji nr. 9049/2003, kërkojnë që subjektet deklaruese të identifikojnë personat e tjerë të lidhur apo shoqëritë me të cilat subjektet janë në marrëdhënie interesash apo detyrimesh, me qëllim ekspozimin e këtyre personave që ligjet i përkufizojnë si “*persona të tjerë të lidhur*” ndaj kontrollit të organeve verifikuese në drejtim të pasurisë e të konfliktit të interesit.

ii) Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting* si huadhënëse të shumës prej 1.200.000 lekësh, vajzën e tezes së saj, znj. G. N., duke përcaktuar edhe burimin e krijimit të kësaj shume si nga biznesi tregtar i bashkëshortit të saj. Në të njëjtën mënyrë, ka deklaruar lidhur me këtë shumë edhe në DPV-2010. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti ka modifikuar burimin e krijimit të kësaj shume, duke deklaruar se ajo është krijuar prej huadhënëses nga një marrëdhënie tjetër huaje me djalin e tezes së kësaj të fundit, z. A. G.

iii) Në këto kushte, duke qenë se marrëdhënia e z. A. G. me huadhënësen G. N. mbetet, sipas subjektit, i vetmi burim i identifikuar, që ka mundur krijimin e shumës së marrë hua prej saj, dhe meqenëse huadhënësja N. pranohet edhe prej subjektit, se është në pamundësi për të krijuar këtë shumë, mosdeklarimi prej subjektit i z. A. G. si huadhënësi/krijuesi i vërtetë i shumës së marrë hua prej saj në deklaratën *vetting* dhe në DVP-2010, është një qëndrim që

e bën të pamundur besueshmërinë e deklaramit të subjektit rreth këtyre fakteve në një fazë të avancuar të procesit. Në kushtet kur shpjegimet lidhur me personin që ka krijuar në mënyrë origjinare shumën e marrë hua, janë bërë vetëm përgjatë hetimit administrativ në Komision, dhe huadhënësia e shumës 10.000 euro nga z. G. te znj. G. N., nuk provohet me akte të kohës në të cilën pretendohet nga subjekti se është marrë kjo shumë, vetëm deklarimi i këtyre fakteve në një fazë të avancuar të procesit administrativ, apo edhe mosekzistenca e një arsyeje që bind për vetë qenien e marrëdhënieve të deklaruara (*sipas subjektit, huadhënësja G. N. është e papunë dhe pa të ardhura dhe megjithatë huan e marrë prej kushëririt të saj për hapjen e një aktiviteti dhe punësimin e përdor për të ndihmuar kushërirën gjyqtare për shlyerje e parakohshme të një kredie për blerje apartamenti*), i bën këto shpjegime të konsiderohen si përpjekje të subjektit për të gjetur burime të ardhurash që mundësojnë provimin e ligjshmërisë të shumës së marrë hua prej saj, në kushtet e pamundësisë për të provuar se huadhënësja e deklaruar si e tillë, qoftë në deklaratën *vetting*, qoftë në DPV-2010, kishte burime të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj shume.

**23.18.** Pavarësisht qëndrimit ligjor të arsyetuar më lart, sipas të cilit subjekti gjendet në shkelje të detyrimit të përcaktuar në shtojcën nr. 2 të ligjit nr. 84/2016, për deklaramin e burimit të krijimit të një pasurie, si dhe shpjegimeve jobindëse dhe të paarsyeshme që të dy individët e përmendur si huadhënës, kanë pasur mundësi/motive /arsye për të ndihmuar me hua subjektin për shlyerjen e parakohshme të kredisë, Kolegji, për një vlerësim sa më të plotë të këtij shkakut ankimi, kreu analizën financiare për të verifikuar mundësinë e të dy individëve të deklaruar si huadhënës, për krijimin me të ardhura të ligjshme të shumës së pretenduar të dhënë hua. Në të dyja versionet e analizave financiare, referuar akteve të administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se si huadhënësja G. N., ashtu edhe personi tjetër A. G.<sup>8</sup>, nuk provojnë me dokumentacion justifikues, në zbatim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, krijimin e të ardhurave që do të justifikonin ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua subjektit.

**23.19.** Në konkluzion të analizës së bërë për shkakun e ankimit që ka të bëjë me huan prej 1.200.000 lekësh, të marrë prej subjektit të rivlerësimit nga kushërira e saj, huadhënësja G. N. në vitin 2010, e cila është përdorur prej subjektit për pagimin para kohe të kredisë tregtare të marrë prej saj në Bankën Alpha, Kolegji, pasi analizoi pretendimet e subjektit në raport me konkluzionet e Komisionit lidhur me këtë çështje, vlerësoi si të drejta qëndrimet e Komisionit, si vijojnë.

---

<sup>8</sup> Dokumentacioni i paraqitur përgjatë hetimit administrativ nga subjekti i rivlerësimit për të justifikuar burimin e ligjshëm të shumës së marrë hua nga z. A. G., është si në vijim:

- Busta paga (pagesat mujore) të shtetasit A. G. për periudhën nga viti 2007 e në vazhdim, konfirmuar ky fakt para noterit (me vulë apostile); janar 2010, me pagë neto 943 euro; dhjetor 2009, me pagë neto 923 euro.
- Karta e identitetit me nr. {\*\*\*}, e shtetasit A. G., lëshuar më datë 11.08.2016, nga Komuna Gorgo Al Monticano (me vulë apostile).
- Vërtetim i datës 08.11.2019, lëshuar nga administratori i shoqërisë italiane {\*\*\*}, P. S., në të cilin vërtetohet që z. A. G., i datëlindjes 20.06.1982, me kod fiskal {\*\*\*}, rezident në {\*\*\*}, është punësuar nga firma "{\*\*\*}", me kod fiskal {\*\*\*}, më datë 25.07.2007 dhe më pas kjo kompani u bashkua nga përfshirja J. C.. Nga tetori 2009, z. A. G. është punësuar me kontratë të përhershme për drurin industrial.
- Deklaratë noteriale e lëshuar më datë 26.02.2020, në zyrën noteriale të noteres A. L., në Treviso Itali, në të cilën z. A. G. deklaroi se i ka dhënë hua vajzës së tezes G. N., në gusht të vitit 2009, shumën prej 10.000 eurosh, si kredi për të filluar një biznes si parukiere. Gjithashtu, z. A. G. deklaroi që këtë shumë, znj. G. N. (për shkak se nuk ka mundur të hapë biznesin privat) ia ka dhënë vajzës tjetër të tezes, znj. Bernina Kondi, për të mbyllur kredinë bankare, shumë e cila i është kthyer në tetor 2019. Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ, analiza financiare e personit tjetër të lidhur, z. A. G., rezulton në pamundësi financiare për të dhënë hua shumën 10.000 euro vajzës së tezes G. N., pasi dokumentacioni vërtetoi me të ardhura të ligjshme, vetëm për 2 muaj të cilët janë pas periudhës së dhënies së huas, në gusht të vitit 2009:
  - dhjetor 2009, në shumën 923 euro;
  - janar 2010, në shumën 943 euro.



i. Subjekti ka dështuar të provojë në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, burimin e ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga huadhënësja.

ii. Mbetën në nivel deklarativ e të paprovuara pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, se shuma e marrë hua prej saj, realisht është krijuar jo nga huadhënësja G. N., por nga kushëriri tjetër i subjektit, z. A. G., i cili i kishte krijuar këto të ardhura nga punësimi në Itali, në kushtet kur kjo situatë nuk gjen asnjë pasqyrim në deklaratën *vetting*, në të cilën përcaktohet se burimi i krijimit të kësaj huaje janë të ardhurat e huadhënësës nga aktiviteti privat dhe të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, dhe as në deklaratën periodike të vitit 2010 apo në deklaratimet e subjektit para ILDKPKI-së.

iii. Edhe në version hipotetik se si burim i krijimit të shumës së dhënë hua kanë shërbyer të ardhurat e krijuara nga z. A. G., subjekti, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, dështoi të provojë se ky i fundit ka pasur të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës së marrë hua.

23.20. Në drejtim të analizës financiare të subjektit, në funksion të identifikimit të burimeve të ligjshme që subjekti ka pasur në dispozicion për pagesa të kësteve të apartamentit 57 m<sup>2</sup>, Kolegji mori në analizë edhe pretendimin e subjektit të rivlerësimit se *analiza financiare e kryer nga Komisioni për vitin 2004, në funksion të të ardhurave të ligjshme që ka pasur subjekti për blerjen e apartamentit 57 m<sup>2</sup>, është afektuar me pa të drejtë edhe nga kostot e jetesës, të cilat subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, pretendon se, meqenëse ajo ka jetuar me prindërit, këto kosto janë mbuluar prej tyre*. Nga analiza e kryer, duke konsideruar si shpenzime jetese vetëm për një person, ashtu siç është vepruar edhe në rastet e tjera të gjykuara në Kolegj, rezultoi se subjekti kishte një balancë pozitive në këtë vit, për pasojë, shqyrtimi i mëtejshëm i këtij pretendimi u konsiderua pa relevancë për zgjidhjen e çështjes.

24. *Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për zërat e analizës financiare të vitit 2010, të kryer nga Komisioni, u konstatua dhe reflektua sa vijon.*

24.1. Sipas vendimit të Komisionit objekt shqyrtimi, rezulton se analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2010, rezulton në balancë negative në shumën 1.593.639 lekë.

24.2. *Sipas pretendimeve të subjektit në ankim, analiza financiare e vitit 2010 duhet të rezultojë në balancë pozitive prej (+) 61.637 lekësh, duke pretenduar se në këtë analizë duhen konsideruar:*

- përfshirja si e ardhur e shumës 1.200.000 lekë, e marrë hua nga vajza e tezes G. N.;
- përfshirja në analizën financiare të vitit 2010, e pakësimit të gjendjes së *cash*-it në masën 400.000 lekë;
- pakësimi i kostove të përllogaritura në zërin e shpenzimeve të udhëtimit, me pretendimin se një nga udhëtimet e bashkëshortit ka qenë udhëtim pune dhe i justifikuar me dokumentacion nga organizatorët;
- pakësimi i shpenzimeve për telefon, pasi subjekti pretendon se ky shpenzim është mbuluar nga gjykata (vlera e pretenduar për t'u zbritur, në shumën 27.754 lekë).

24.3. Në analizë të secilit prej elementeve të mësipërme që subjekti pretendon të ndryshohen në zërat e analizës financiare të vitit 2010, Kolegji konstaton *së pari*, se në arsyetimin si më lart, ka mbajtur qëndrim lidhur me mosprovueshmërinë e burimeve të ligjshme për krijimin e shumës prej 1.200.000 lekësh, të deklaruar si hua e marrë nga kushërira e subjektit, për pasojë, në analizën financiare të këtij viti, ashtu si edhe Komisioni, nuk do të konsiderohet kjo vlerë si një e ardhur e ligjshme e subjektit të rivlerësimit. Përpos qëndrimit të mësipërm, Kolegji u ndal në analizimin e të gjitha elementeve të tjera të sipërcituara që subjekti identifikon se ndikojnë në analizën e këtij viti.

24.4. *Lidhur me pretendimin për pasqyrimin në analizën financiare të vitit 2010, të pakësimit të gjendjes së cash-it në masën 400.000 lekë, Kolegji konstaton se në DPV-2010, subjekti ka*

deklaruar: *shtesë nga paga vjetore e bashkëshortit (kursime) në shumën 500.000 lekë, shtesë nga kursimet vjetore në shumën 500.000 lekë (paga e deklarueses)*. Nisur nga ky deklaram i subjektit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010, i cili është i vetmi dokument nga i cili marrim informacion lidhur me ndryshimet e gjendjes së kursimeve në *cash*, rezulton se ato (kursimet) janë deklaruar vetëm si shtesa në këtë vit, pa deklaruar ndonjë pakësim të tyre apo pa u përdorur si burim për krijimin e ndonjë pasurie apo përballimin e ndonjë shpenzimi të kryer në këtë vit. Për pasojë, referuar edhe një qëndrimi të konsoliduar tashmë, të mbajtur në jurisprudencën e tij, Kolegji nuk e konsideroi të provuar këtë pretendim të subjektit, për sa kohë që ai nuk gjen pasqyrim në deklaratën periodike të vitit kur pretendohet se ka ndodhur veprimi, dhe nuk e pasqyroi atë në analizën financiare të vitit 2010, sipas pretendimit të saj.

**24.5.** *Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën e vitit 2010, duhen pakësuar kostot e përlllogaritura në zërin e shpenzimeve të udhëtimit, pasi një nga udhëtimet e personit të lidhur ka qenë udhëtim pune dhe i justifikuar me dokumentacion nga organizatorët*, Kolegji analizon sa vijon.

**24.6.** Në fashikullin e hetimit administrativ, së bashku me shkresat dhe dokumentet justifikuese të shpenzimeve të udhëtimeve të kryera nga subjekti dhe personi i lidhur, ndër të tjera gjendet urdhri nr. {\*\*\*}, datë 8.11.2010, i lëshuar nga Sektori i Buxhetit, Kontabilitetit dhe Investimeve pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në të cilin saktësohet se shpenzimet e udhëtimit të datës 3 nëntor drejt Maqedonisë (Tetovë), janë mbuluar nga Prokuroria e Përgjithshme, si dhe dokumenti “Notë verbale NV N057/2010”, lëshuar nga Bashkimi Evropian nëpërmjet delegacionit në Shqipëri, mbi organizimin e trajnimit rajonal në “IPR Crime” në Zagreb, Kroaci, për periudhën 27-29 prill 2010. Sipas kësaj note verbale, Komisioni Evropian do të mbulojë të gjitha shpenzimet e udhëtimit dhe akomodimit për të gjithë pjesëmarrësit e ftuar, ndër të cilët është edhe bashkëshorti i subjektit. Nga verifikimi i të dhënave të sistemit TIMS, konstatohet që për vitin 2010, subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë udhëtim jashtë shtetit, ndërsa bashkëshorti i saj ka pasur vetëm dy udhëtime, përkatësisht më datë 03.11.2010 (kthim brenda ditës) dhe më datë 26.04.2010 (kthimi më datë 30.04.2010), udhëtime që korrespondojnë me dokumentacionin justifikues të cituar më sipër. Nisur nga të dhënat e marra nga aktet e mësipërme, Kolegji konstatoi se pretendimi i subjektit se analiza financiare e vitit 2010 nuk duhet të ngarkohet me kosto për shpenzime udhëtimi jashtë vendi, është një pretendim i drejtë, i mbështetur në prova dhe, për pasojë, Kolegji, në analizën e kryer për vitin 2010, nuk përfshiu asnjë kosto për shpenzimet e udhëtimit.

**24.7.** *Lidhur me pretendimin e subjektit se në analizën e vitit 2010, duhen pakësuar kostot e përlllogaritura në zërin e shpenzimeve për telefon, pasi subjekti i rivlerësimit pretendon se janë mbuluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në shumën 27.754 lekë*, Kolegji analizon sa vijon.

**24.8.** Subjekti i rivlerësimit, me ankimin, kërkon që shpenzimet e telefonisë të jenë më të vogla se ato të përlllogaritura nga Komisioni, me një vlerë totale prej 10.039 lekësh, ndërkohë që vlera e vendosur nga Komisioni, u referohet të dhënave në tabelën e përcjellë nga gjykata, tek e cila, për vitin 2010, mbetja rezulton në shumën 37.561 lekë. Përgjatë hetimit administrativ, subjekti ka paraqitur akte që provojnë mbulimin e këtyre shpenzimeve nga gjykata<sup>9</sup>.

<sup>9</sup> Aktet që subjekti ka paraqitur për të provuar se shpenzimet e telefonisë janë mbuluar nga Gjykata Berat, pranë së cilës subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka ushtruar detyrën e kryetares, janë:

➤ Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 9.02.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në të cilën vërtetohet që subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në pozicionin e kryetares së Gjykatës Berat për periudhën 01.06.2008 - 13.09.2012, është trajtuar sipas VKM-së nr. 343, datë 11.07.2002, ndryshuar me VKM-në nr. 864, datë 23.07.2010, “Për pajisjen me numër telefoni celular personat juridikë, publikë”, Vendim të Bordit nr. {\*\*\*}, datë 16.12.2002 dhe shkresës së ZABGJ nr. {\*\*\*}, datë 20.11.2002, shpenzimet e telefonit për kryetarin e gjykatës mbulohen deri në masën 15.000 lekë/muaj.

**24.9.** Duke konsideruar se informacioni i ofruar nga dokumentacioni që subjekti ka paraqitur përgjatë hetimit administrativ në drejtim të shpenzimeve të telefonisë, si dhe nisur nga fakti që në rastet kur ka hasur shpenzime telefonie që nuk tejkalojnë dukshëm vlera që mund të shpenzohen për këtë zë, Kolegji nuk i ka trajtuar shpenzimet e telefonisë si zë më vete në analizën financiare, por ato janë konsideruar si shpenzim i përfshirë në kategorinë e shpenzimeve të jetesës [*vlerë e cila është përlllogaritur nga INSTAT-i sipas strukturës së shpenzimeve për konsum të Njësive Ekonomike Familjare (NjEF), në të cilën shpenzimet për komunikim zënë rreth 3,4% të vlerës totale*], edhe në rastin objekt shqyrtimi, Kolegji çmoi që analiza financiare të mos ngarkohej me shpenzimet e telefonisë, duke e konsideruar në këtë mënyrë të drejtë pretendimin e subjektit.

**24.10.** Në përfundim, Kolegji kreu analizën financiare për vitin 2010, mbështetur në pretendimet e subjektit të paraqitura në ankim dhe të pranura si të drejta, që lidhen me mospërfshirjen në këtë analizë të shpenzimeve për telefoninë celulare dhe udhëtimet. Në analizë, nuk u konsideruan pretendimet e subjektit që lidheshin me përfshirjen e huas në të ardhurat e vitit dhe pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën prej 400.000 lekësh. Lidhur me huan, Kolegji mbajti këtë qëndrim për sa arsyetuar më lart, ndërsa lidhur me pakësimin e gjendjes në *cash*, nuk e llogariti atë, duke qenë se pakësimi i pretenduar nuk ka gjetur pasqyrim në asnjë deklaratë të subjektit të rivlerësimit, qoftë periodike, apo *vetting*. Mbi këto konkluzione, Kolegji kreu analizën financiare për këtë vit, nga e cila rezultoi se subjekti rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar pagesën e kredisë së marrë prej saj në Bankën Alpha, si dhe për të mbuluar shpenzimet e jetesës, në vlerën prej (-)1.493.613 lekësh. Ky rezultat e çoi Kolegjin në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, edhe për këtë çështje, është i drejtë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**24.11.** Në vijim të shkaqeve të ankimit që lidhen me analizën financiare, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, konsideron të padrejtë *qëndrimin e Komisionit se në vitin 2012, ajo gjendej me balancë negative në shumën (-) 203.615 lekë, balancë e cila vjen për shkak të llogaritjes së gabuar që Komisioni ka bërë për shpenzimet e kryera prej subjektit për mobilimin e banesës*. Lidhur me këtë pretendim, konstatohet e analizohet si vijon.

**24.12.** Lidhur me këtë çështje, në vendimin e Komisionit është arsyetuar se, në lidhje me shpërndarjen e shpenzimeve të mobilimit, subjekti, edhe pse është pyetur disa herë nga Komisioni, në përgjigjet e dhëna, nuk ka kryer ndonjë ndarje të këtyre shpenzimeve, por e ka deklaruar shumën e shpenzuar në total dhe se ajo nuk ka dorëzuar ndonjë dokumentacion justifikues për të provuar shpenzimet, me qëllim saktësimin e kohës së kryerjes së tyre.

**24.13.** Rezulton se shpenzimet e mobilimit të apartamentit ku banon subjekti, të ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, të deklaruara prej saj në shumën 800.000 lekë, janë konsideruar prej Komisionit si të kryera: 60%, që përbëjnë shumën 480.000 lekë, në vitin 2012; dhe 40%, që përbëjnë shumën 320.000 lekë, në vitin 2013. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, kjo shtëpi është blerë në muajin tetor 2011 dhe ajo ka filluar të banojë në të në vitin 2012. Mobiliet e kuzhinës dhe dollapët e dhomës janë porositur dhe paguar paraprakisht që në vitin 2011, në masën 300.000 lekë, e në të tilla rrethana, vetëm vlera prej 180.000 lekësh duhet të përlllogaritet si shpenzim në vitin 2012, ndërsa diferenca prej 320.000 lekësh është përdorur prej saj për mobilim të apartamentit prej vitit 2012 e deri në vitin 2017, gradualisht, vit pas viti.

- 
- *Tabelë likuidimi e faturave për telefonin celular, në të cilën të dhënat e vitit 2010, rezultojnë në vlerë totale sipas faturave, në shumën 200.752 lekë, në shumën e likuiduar nga gjykata me urdhër shpenzim, në shumën 149.907 lekë dhe në diferencën e mbetur në shumën 37.561 lekë.*
  - *Faturat përkatëse të vitit 2010, sipas muajve.*

**24.14.** Kolegji konstaton se lidhur me vlerën e mobilimit të apartamentit dhe shpërndarjes së kësaj vlere në vite, subjekti është pyetur prej Komisionit me pyetësin nr. {\*\*\*}. Sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në përgjigjet e këtij pyetësi, rezulton se prej saj<sup>10</sup>, nuk është dhënë përgjigje sipas kërkesës së Komisionit, por është mjaftuar vetëm me dhënien e vlerës së shpenzuar për mobilim, në shumën 800.000 lekë dhe me dhënien e informacionit se apartamenti është vënë në shfrytëzim në vitin 2012. Komisioni, në mungesë të përgjigjeve shteruese nga ana e subjektit, ka përdorur një logjikë ekonomike, duke ndarë shpenzimin në 60% në vitin 2012 dhe pjesën tjetër në vitin 2013.

**24.15.** Në analizë të sa më sipër, Kolegji arsyeton se pretendimi i subjektit për të zhvendosur shpenzimet e mobilimit që Komisioni i kishte përfshirë në analizën financiare të vitit 2012, në vitin 2011, nuk ishte ngritur prej subjektit përgjatë hetimit administrativ, edhe pse nga Komisioni, ajo është pyetur disa herë për shpërndarjen e vlerës së këtij shpenzimi. Përgjigjet e subjektit lidhur me këtë shpenzim, kanë qenë evazive dhe të paqarta, faktorë që kanë detyruar Komisionit t'i shpërndajë ato sipas një logjike ekonomike. Pretendimet e subjektit të bëra prezente rreth këtyre shpenzimeve vetëm në ankim, nuk arritën të bindin Kolegjin për besueshmërinë e tyre dhe cenimin e rivlerësimit të Komisionit për to. Për pasojë, pas kryerjes së analizës financiare në Kolegji, rezultoi se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të përballuar shpenzimet edhe për këtë vit, në vlerën e 159.186 lekëve, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**24.16.** Kolegji gjithashtu shqyrtoi edhe pretendimin e subjektit, *sipas të cilit konsiderohet si i padrejtë qëndrimi i Komisionit në lidhje me balancën negative të vitit 2005, prej (-) 67.810 lekësh.*

**24.17.** Sipas Komisionit, për periudhën deri më 20.04.2005, subjekti ka qenë në pamundësi financiare në shumën (-) 67.810 lekë, vit kur subjekti ka blerë automjetin<sup>11</sup> tip “Opel Corsa”, në shumën 200.000 lekë. Gjithsesi, Komisioni në vendim është shprehur që pavarësisht kësaj diference negative, ky konstatim nuk do të konsiderohet si shkak në këtë vendimarrje.

**24.18.** Kolegji, në analizë të këtij shkak, konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në ankim pretendon që analiza financiare e periudhës janar – prill 2005, duhet të rezultojë pozitive pasi, sipas saj, Komisioni ka gabuar në përlllogaritjen e ndryshimit të likuiditeteve, sepse ajo ka deklaruar të dhëna vjetore dhe për Komisionin ka qenë e pamundur të përlllogaritej ndryshimi i likuiditeteve në një moment të caktuar gjatë vitit. Sipas subjektit, shuma e përcaktuar si ndryshim likuiditeti në masën 188.941 lekë, përfaqëson kursimin e mundshëm për periudhën, kursim i cili mund të ishte edhe më i madh pasi të ardhurat e saj për këtë periudhë, janë të tilla që mbulojnë shpenzimet e jetesës dhe krijojnë mundësi për më shumë kursime të akumuluar. Sipas subjektit, në tabelën e analizës financiare, kjo shumë duhet të barazohet me zero. Kolegji vlerëson se ky pretendim i subjektit mund të vijë për shkak të paqartësisë në lidhje me konceptin e “ndryshimit të likuiditetit”, të cilin subjekti e konsideron si përlllogaritje të mundësisë për kursim. Në këtë drejtim, Kolegji konstaton se ndryshimi i likuiditetit në tabelën e analizës financiare të Komisionit, lidhet dhe përfaqëson ndryshimin e sasisë së parave në llogaritë bankare të subjektit mes dy periudhave, në fillim të vitit dhe në momentin e kryerjes së analizës financiare (datë 20.04.2005), që ka të bëjë me sasinë e parave të shtuara apo pakësuara në to gjatë periudhës së rivlerësimit. Në rastin konkret, gjendja e llogarisë bankare të subjektit pranë Bankës Raiffeisen, më datë 31.12.2004, ka qenë

---

<sup>10</sup> Bashkë me ankimin, subjekti ka paraqitur një deklaratë nr. {\*\*\*}, datë 04.08.2020, të lëshuar nga administratorja e subjektit tregtar “{\*\*\*}”, me numër NIPTI {\*\*\*}, me seli në Kuçovë, Berat, nëpërmjet së cilës kërkon të provojë faktin se kundrejt pagesës së kryer në vitin 2011, prej 300.000 lekësh, subjekti ka porositur një dhomë gjumë, pajisjet elektroshtëpiake dhe dollapë. Subjekti në ankim nuk shpjegon, në kuptim të neneve 47 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012 se cilat ishin shkaqet që ajo nuk e ka paraqitur këtë provë në Komision, në përgjigje të pyetjeve për të saktësuar shpenzimet e mobilimit.

<sup>11</sup> Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20.04.2005.

23.957 lekë. Gjendja e llogarisë bankare në datën 20.04.2005, ka qenë 212.898 lekë. Ndryshimi i likuiditeteve është rrjedhimisht: 212.898 lekë - 23.957 lekë = 188.941 lekë, që do të thotë që kjo shumë është shtuar në bankë dhe gjendet aty objektivisht në momentin e blerjes së autoveturës, tip “Opel Corsa”.

**24.19.** Në përfundim të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, Kolegji vlerëson se analiza e Komisionit është e drejtë, dhe rezultati prej (-) 67.810 lekësh tregon që subjekti në momentin e blerjes së autoveturës, tip “Opel Corsa”, ka qenë në pamundësi financiare për krijimin me burime të ligjshme të shumës së sipërcituar. Pavarësisht miratimit të këtij rezultati financiar, Kolegji nuk e konsideroi këtë shumë si të mbledhshme në totalin e balancave negative të subjektit, përderisa vetë Komisioni nuk e ka konsideruar si të tillë, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*.

25. Lidhur me pretendimet e subjektit *për balancën negative të konstatuar nga Komisioni në vitin 2006 e që lidhet me derdhjen e shumës 101.000 lekë në llogarinë e kredisë në Bankën Alpha*, Kolegji konstatoi dhe analizoi si vijon.

**25.1.** Komisionit, nga verifikimi i *statement*-it të llogarisë së kredisë, të përcjellë nga Banka Alpha, i ka rezultuar se subjekti ka kryer një derdhje në shumën 101.000 lekë në datën 11.01.2006. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, subjekti nuk ka deklaruar gjendje *cash*. Mbi këto konstatime, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare për të krijuar brenda 11 ditëve, shumën 101.000 lekë dhe, për pasojë, gjendej në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar këtë shpenzim.

**25.2.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në ankimin e saj, ka kundërshtuar qëndrimin e Komisionit, duke parashtruar se për derdhjen në shumën 101.000 lekë, në datën 11.1.2006, janë investuar kolegë të saj në marrëdhënie shoqërore në ambientet e punës, sikurse mund të ndodhte herë pas here, me qëllim shlyerjen e kësteve të kredive pa kamatëvonesa dhe në kohë, veprime këto të kryera në mënyrë reciproke mes kolegësh. Subjekti ka sqaruar se këto hua merreshin midis shoqërisë, prej një ose më shumë personave dhe afatet e tyre ishin deri në datat e kalimit të pagës së radhës, apo të 2-3 pagave pasardhëse dhe në rastin më të parë të mundshëm, shlyheshin me korrektesën shoqërore, duke rezultuar në fund të periudhave vjetore të shlyera dhe pa hua individuale.

**25.3.** Kolegji, në vlerësim të këtij shkaku ankimi, konstaton se shpjegimet e subjektit për të kundërshtuar këtë qëndrim të Komisionit, mbeten deklarative dhe të paprovuara me asnjë dokumentacion ligjor. Ndihma e dhënë prej kolegëve, përveçse është deklaruar prej subjektit vetëm pas kalimit të barrës së provës dhe në asnjë rast më parë si burim për justifikimin e këtij shpenzimi, nuk krijoi bindjen e trupës se ka ndodhur vërtet dhe pavarësisht vlerës së vogël negative që shkakton kjo situatë, Kolegji vlerëson të nënvizojë qëndrimin e tij se deklarimet për burimet e krijimit të pasurive, duhet të gjejnë pasqyrim në përputhje me ligjin, në deklaratën *vetting* dhe ato periodike, përndryshe subjektet vihen në kushtet e pamundësisë për të vërtetuar me deklarime të mëpasshme ekzistencën e tyre, në funksion të procesit të rivlerësimit.

**25.4.** Në përfundim, Kolegji vlerëson se në vitin 2006, subjekti i rivlerësimit gjendet me mungesë të burimeve të ligjshme për pagesën/derdhjen në bankë të shumës prej 101.000 lekësh, pasi edhe nga analiza e kryer në Kolegji, u gjend në pamundësi financiare për të krijuar me burime të ligjshme këtë shumë në datën 11.01.2006, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

26. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit *për sa i përket qëndrimin të Komisionit për vlerësimin e kredisë me kushte lehtësuese të marrë në vitin 2011, në shumën 5.000.000 lekë, e cila ka shërbyer si një nga burimet e financimit të apartamenti të ndodhur në rrugën “Islam Alla”, në Tiranë*, Kolegji analizon sa vijon.

**26.1.** Në vendimin e Komisionit, për kredinë me kushte lehtësuese të marrë nga subjekti në vitin 2011, në shumën 5.000.000 lekë, është konkluduar se:

*Për pasurinë e renditur me nr. {\*\*\*}, veprimet juridike të kryera nga subjekti i rivlerësimit në funksion të përfitimit të një kredie me kushte lehtësuese, për të financuar blerjen e një banese tjetër në Tiranë, që, nga hetimi administrativ, subjekti rezulton ta ketë në pronësi të tij, janë kryer në tejkalim të parashikimeve ligjore mbi përfitimin e kredisë.*

**26.2.** Për analizimin e këtij shkak ankimi, Kolegji konstaton se elementet që kanë çuar Komisionin në arsyetimin se kjo kredi është marrë nga subjekti në tejkalim të kërkesave ligjore, dhe konkretisht VKM-së nr. 600, datë 12.9.2007, “Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve politikë” (në vijim “VKM nr. 600/2007”), janë:

(i) Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka porositur me kontratë porosie në muajin maj 2011, një banesë në qytetin e Beratit, në të cilin ushtronte funksionin si gjyqtare, për blerjen e së cilës iu akordua mbi bazën e VKM-së nr. 600/2007, kredia me kushte lehtësuese, në shumën 5.000.000 lekë. Këtë kontratë porosie, rezulton se subjekti e ka revokuar duke blerë pas katër muajsh, edhe me fondet e kredisë lehtësuese, një apartament në Tiranë, me sipërfaqe 90,12 m<sup>2</sup>.

(ii) Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, bleu në Tiranë apartamentin, në një kohë kur nuk ushtronte detyrën e gjyqtares pranë këtij qarku.

(iii) Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, në vitin 2011, kur me fondet e kredisë me kushte lehtësuese, së bashku me bashkëshortin, bleu apartamentin 97 m<sup>2</sup> në Tiranë, dispononte po në Tiranë, edhe një apartament tjetër, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, të blerë prej saj në vitin 2005.

**26.3.** Përgjatë hetimit administrativ, në shpjegimet në seancë, si dhe në ankim, subjekti pretendon se banesa e saj e parë që ajo dispononte në rrugën “{\*\*\*}”, në Tiranë, ishte shumë e vogël, vetëm 57 m<sup>2</sup> dhe, si e tillë, nuk përmbushte kërkesat e pikës 5 të VKM-së nr. 600/2007 dhe se ajo faktikisht e ka blerë banesën në Tiranë, ndërkohë që nuk ushtronte efektivisht funksionet e gjyqtares në Berat, për shkak të lejes së shtatzënisë, deri në emërimin në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**26.4.** Kolegji mori në shqyrtim pretendimin e këtij shkak ankimi në këndvështrim veçanërisht të konkluzionit të arritur prej Komisionit lidhur me të. Për nga sa ka konkluduar Komisioni, nuk rezulton qartësisht se në cilin kualifikim ligjor ai e ka atashuar konkluzionin e tij se kredia është marrë në tejkalim të përcaktimeve e kriterëve ligjore për përfitimin e saj. Komisioni nuk rezulton të ketë marrë ndonjë qëndrim lidhur me legjitimitetin e pasurisë së krijuar nëpërmjet kredisë apo ndonjë konkluzion sipas ndonjë prej rasteve të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, duke e lënë në nivel konstatimi qëndrimin e tij e pa ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me ndonjë shkak shkarkimi të parashikuar shprehimisht në ligj.

**26.5.** Ndonëse nga të dhënat që kanë buruar nga aktet në dosjen e hetimit administrativ, ka fakte që dëshmojnë për veprime të subjektit në tejkalim apo në mashtrim të ligjit, me qëllim përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese, jo për financimin e një apartamenti në Berat, por në Tiranë, mungesa e konkluzionit të Komisionit për përcaktimin e këtij qëndrimi si me pasojë në kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe në mungesë të vlerësimit të kriterit të aftësisë profesionale, apo në pamundësi të marrjes së një qëndrimi lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, sipas përcaktimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e dërgon Kolegjin në përfundimin se, me gjithë dakordësinë për konstatimin e fakteve si Komisioni ka përcaktuar dhe vlerësimin që ai ka bërë për sjelljen e subjektit, konkluzioni i arritur nuk mund të përdoret si një element për t’u kualifikuar nën përcaktimet e nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Pavarësisht se nuk mund të identifikohet si një shkak shkarkimi sipas parashikimit të mësipërm, dhe në pamundësi për të konsideruar zbatimin e nenit 61, pika 5 e po këtij ligji, duke qenë se procesi është kryer mbështetur vetëm në konkluzionet e një kriteri, Kolegji mori

në konsideratë këtë situatë faktike, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, e cila tregon për kryerjen e veprimeve në tejkalim të ligjit për krijimin e pasurisë, prej subjektit.

27. Lidhur me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, se *mospërputhjet e deklarimit të subjektit në ILDKPKI, në vitin 2012, me ato të dhëna përgjatë hetimit administrativ në Komision për automjetin tip “Benz 2000”, me targë {\*\*\*}, duhet të konsiderohen si pasaktësi që nuk mund të afektojnë procesin e saj të rivlerësimit dhe se është e padrejtë analiza e Komisionit për blerjen e automjetit “Opel Corsa” në vitin 2005, Kolegji konstaton dhe analizon sa vijon.*

27.1. Referuar automjetit tip “Benz 2000”, me targë {\*\*\*}, nga aktet në fashikull, rezulton se në DPV-2005, subjekti ka deklaruar: *shitje e autoveturës tip “Benz 2000”, me targa (\*\*\*), vlera e shitjes 600.000 lekë dhe pjesa takuese 100%.*

Komisionit, gjatë korrespondencës së mbajtur me DPSHTR-në, i ka rezultuar se subjekti nuk e ka pasur në pronësi këtë automjet dhe, pasi ka pyetur subjektin e rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, pas vënies në dijeni të këtij informacioni, ajo ka deklaruar se: *[...] ky automjet është blerë nga familja ime kur unë kam qenë studente në Fakultetin e Drejtësisë, shumë vite më parë se unë të bëhesha subjekt deklarimi. Deklaroj se unë nuk kam qenë asnjëherë pronare e këtij automjeti. Me këtë automjet, familja ime ka pësuar një aksident në vitin 2006, si pasojë automjeti ka dalë jashtë përdorimit dhe pjesët e tij janë shitur në kohë të ndryshme pjesë-pjesë. Saktësoj se deklarimi i këtij automjeti në deklaratën time të parë në ILDKPKI, ka qenë për paraqitje korrekte të deklarimeve të mia pasurore, duke plotësuar edhe deklarinë e përdorimit të mjeteve të transportit. Qëllimi i këtij deklarimi ka qenë për të paraqitur këtë mjet transporti të familjes, që ndonjëherë edhe unë e kam përdorur.*

27.2. Kolegji vëren se Komisioni, për sa kohë që ky automjet nuk ka rezultuar se ka qenë në pronësi të subjektit, si dhe nuk provohet me dokumentacion shitja dhe shuma e përfituar nga shitja e tij, nuk i ka përfshirë në analizë të ardhurat nga shitja e tij. Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje mes deklarimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ me deklarinë dhe dhëna për këtë pasuri në ILDKPKI, në datën 06.03.2012, për të cilat, në vendimin e Komisionit, konkludohet se: *Në analizim të dokumentacionit të administruar, shpjegimeve të dhëna nga subjekti, si dhe faktit që të ardhurat e pretenduara nuk kanë shërbyer si burim për ndonjë pasuri, çmon se mospërputhjet e konstatuara nuk ndikojnë në këtë vendimmarrje.*

27.3. Në këto kushte, Kolegji vëren se kur çështja e shitjes së automjetit tip “Mercedes Benz” në vendimin e Komisionit, është qartazi e evidentuar që nuk ka ndikuar vendimmarrjen, ky pretendim i subjektit mbetet i paargumentuar, pasi vlerësimi i kësaj çështjeje prej Komisionit, ka ngelur në nivelin e një konstatimi pa ndikim në procesin e rivlerësimit të subjektit.

28. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pavarësisht se Kolegji gjeti të drejta disa pretendime të subjektit të parashtruara në ankim, ato nuk arritën të cenojnë vendimin e Komisionit në tërësinë e tij, në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, i cili nuk arrin nivel të besueshëm pasi subjekti rezultoi të ketë bërë deklarime të pasakta dhe ka mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera në vlerën prej (-) 1.753.799 lekësh.
29. Në vlerësim dhe analizë të konkluzioneve të mësipërme, Kolegji arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, e gjendur në situatat e mësipërme të shkeljes së ligjit, nuk arrin të përmbushë kriteret kushtetuese për arritjen e një niveli të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë sipas kërkesave të nenit D, pikat 1, 3 e 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe, për pasojë, ajo gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, dispozitë e cila urdhëron vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit të saj nga detyra. Për pasojë, vendimi nr. 259, datë 15.06.2020, i

Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, më datë 11.10.2022

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*



## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues, kam mendim paralel ndaj vendimit nr. 37, datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur lënia në fuqi e vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, për sa arsyetuar në vijim.
2. Lidhur me apartamentin e ndodhur në rr. “{\*\*\*}”, Tiranë, me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, Komisioni dhe shumica e trupit gjykues kanë vlerësuar se çmimi real i këtij apartamenti është 47.000 euro, ndërkohë që nga aktet në dosjen gjyqësore, konkretisht në kontratën e sipërmarrjes të vitit 2004, është përcaktuar vlera 39.000 euro. Në vlerësimin tim, të dhënat në kontratë që, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil, *kanë forcën e ligjit për palët*, janë bindëse. Këtë çmim, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe në deklaratën e interesave private të vitit 2004, vit në të cilin është porositur ky apartament, dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, në zbatim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, konkluzioni i trupit gjykues që lë në fuqi konkluzionin e Komisionit, se subjekti nuk ka shpjeguar bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nuk është i bazuar pasi në provat e administruara, konkretisht kontrata dhe deklarimi periodik, të cilit ligji nr. 84/2016, në nenin 32, pika 5 e tij i ka dhënë cilësinë e provës, si dhe fakti i të njëjtit deklarim në deklaratën e pasurisë *vetting*, në vlerësimin tim, të krijojnë bindjen e plotë se pavarësisht pasaktësive të konstatuara, vlera reale e këtij apartamenti është 39.000 euro.
3. Ndryshe nga vlerësimi i shumicës së trupit gjykues në paragrafin 18.2 të këtij vendimi, se përcaktimi në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, *për cenim të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, duhet të jetë një produkt i dalë mbi vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve të rivlerësimit ose tërësor të procedurave, për të aplikuar më pas nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016*, pavarësisht se jam dakord me shumicën e trupit gjykues për mosaplikim të nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016 në këtë çështje, jam kundër interpretimit që bën shumica lidhur me rastet e zbatimit të kësaj dispozite. Në vlerësimin tim, në rastin konkret, çmoj se nuk jemi përpara kushteve të këtij neni, por jo që çështja është duke u vlerësuar në bazë të një kriteri, dhe aplikimi i nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, mund të jetë e zbatueshme edhe në rastet kur procesi i rivlerësimit përfundon me vendimmarrje vetëm për një kriter.
4. Për rrjedhojë të këtij qëndrimi, ndaj mendim ndryshe nga shumica e trupit gjykues dhe për arsyetimin në paragrafin 18.3 të këtij vendimi, ku shprehet se: *[...] përderisa Komisioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë, ka arritur në përfundimin se subjekti gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm sipas pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, ai nuk mund të ndodhet edhe në kushtet e cenimit të besimit të publikut sipas pikës 5 të po këtij neni për të njëjtat problematika, duke e ndëshkuar në këtë mënyrë dy herë për të njëjtën shkelje në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së drejtës*. Për të qartësuar edhe një herë qëndrimin tim lidhur me nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, çmoj se neni 61, pika 3, kur subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë kryer deklarim të pamjaftueshëm për vlerësimin e kriterit të pasurisë, nuk pengon aplikimin në të njëjtën kohë edhe të nenit 61, pika 5, kur ndodhemi para rrethanave të caktuara kur veprimet e parregullta dhe jo në përputhje me ligjin, do të cenonin besimin e publikut tek integriteti profesional i subjektit. Në vlerësimin tim, aplikueshmëria e të dyja dispozitave nuk duhet konsideruar si ndëshkim i dyfishtë, por evidentimi i përgjegjësisë ligjore që subjektet duhet të mbajnë për veprimet e tyre.
5. Në vijim, nuk mbaj të njëjtin qëndrim me shumicën e trupit gjykues në paragrafin 20 të këtij vendimi, ku është shprehur se: *[...] Kolegji, në respektim të kufijve të shqyrtimit të çështjes brenda shkaqeve të ankimit, sipas parashikimit të nenit 465 të Kodit të Procedurës Civile dhe parimit no reformatio in peius, nuk mori në shqyrtim çështje që lidhen me vlerësimin e pasurisë së personit të lidhur, duke mbajtur në konsideratë në këtë gjykim lidhur me to,*

*qëndrimet që ka mbajtur Komisioni në vendimin objekt shqyrtimi e të cilat nuk janë ankimuar prej subjektit të rivlerësimit. Në rastin konkret, shpreh dakordësinë me shumicën se proceset për subjektet e rivlerësimit Bernina Kondi dhe E. K. duhet të jenë të pavarura, por jam kundër arsyetimit të përdorur lidhur me kufijtë e shqyrtimit të çështjes brenda shkaqeve të ankimit, pasi objekt shqyrtimi në Kolegj është kontrolli i vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, i Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, por pa u kufizuar në kufijtë e shkaqeve të ankimit, siç vlerëson shumica, gjë të cilën e parashikon neni F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe neni 49 i ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, kur është rasti, Kolegji mund të shkojë edhe përtej shkaqeve të ankimit për zgjidhjen e drejtë dhe të plotë të çështjes duke respektuar dhe mbajtur parasysh të drejtat themelore të subjektit të rivlerësuar përgjatë procesit, si dhe mbrojtjen e interesit publik.*

**GJYQTARE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

## MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, anëtare e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit (në vijim "Kolegji"), që shqyrtoi ankimin e subjektit të rivlerësimit Bernina Kondi ndaj vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim "Komisioni"), dakordësohem me vendimin e trupit gjykues sa i përket zgjidhjes së çështjes, por po parashtroj një arsyetim paralel, të ndryshëm nga arsyetimi i shumicës, në këtë vendim.
2. Arsyetimi i ndryshëm është për konkluzionin e shumicës, lidhur me vlerën e paguar nga subjekti i rivlerësimit, sa i përket pasurisë apartamentin me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, në të cilin është konfirmuar se qëndrimi i Komisionit ishte i drejtë dhe se subjekti nuk shpjegoi bindshëm vlerën e paguar për këtë pasuri, sipas nenit "D" të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar atë në deklaratën e pasurisë *vetting* në kundërshtim me kërkesat e nenit 33, pika 5, germa "a" e ligjit nr. 84/2016.
3. Në analizë të shkakut të ankimit me të cilin subjekti kundërshton konkluzionin e Komisionit, për deklarim të pasaktë të vlerës së apartamentit me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, çmoj se bazuar në provat e administruara në fashikull, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë çështje, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është bindës dhe i bazuar.

Nga të dhënat që rezultojnë nga aktet e administruara nga hetimi administrativ konstatohet se subjekti këtë pasuri e ka deklaruar si vijon:

i) Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar se *pjesa takuese e saj, për apartamentin me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, është 100 % dhe se vlera totale e apartamentit është 39.000 Euro; me burim krijimi nga kreditë e marrë nga "Alpha Bank", më datë 07.07.2005, në vlerën 2.500.000 lekë, kredi e marrë nga Fondacioni "{\*\*\*}", në datën 18.07.2006, në shumën 500.000 lekë, të ardhurat që dispononte familja e subjektit, si dhe të ardhurat e mbledhura nga shitja e librave të botuara prej subjektit.*

ii) Në DPV-në e vitit 2004, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar: *Kontratë sipërmarrje, datë 21.09.2004, për ndërtimin e një apartamenti; vlera 39.000 euro; pagesa e kryer me këste; pagesa e kështit të parë 12.000 euro nga të ardhurat e familjes dhe nga të ardhurat e librave; është në ndërtim e sipër.*

iii) Në DPV-në e vitit 2005, subjekti për këtë pasuri ka deklaruar: *Paguar shuma 23.000 euro, sipas kontratës gjatë vitit 2003 me kreditë e marrë.*

iv) Gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}, ka shpjeguar se: *Pagesa e këtij apartamenti aktualisht është shlyer totalisht, ka filluar të realizohet kryesisht nga kursimet familjare dhe me kreditë e marrë në vitin 2005, në vlerën 2.500.000 lekë, në "Alpha Bank" dhe në vijim deri në përfundimin e shlyerjes së të gjithë vlerës së tij është likuiduar në mënyrë pjesore të vazhdueshme, ndër vite, sipas parashikimeve në kontratën e sipërmarrjes së datës 21.09.2004 (bashkëngjitur dokumentacioni i pagesave të këtij apartamenti, mandatarkëtimet përkatëse, mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 21.09.2004, mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 25.07.2005 dhe mandatarkëtimi nr. {\*\*\*}, datë 20.07.2006).*

v) Në përgjigje të pyetësorit nr. {\*\*\*}, datë 07.01.2020, të Komisionit, në të cilin subjekti i rivlerësimit Bernina Kondi është pyetur lidhur me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, sipas së cilit kishte paguar shumën 8.000 euro, ajo ka shpjeguar se vlera prej 35.000 eurosh e apartamentit është likuiduar me dy këste, siç edhe e kishte deklaruar në DVP-të 2004 dhe 2005 dhe provuar me mandatarkëtimet nr. {\*\*\*}, datë 21.09.2004<sup>12</sup> dhe nr. {\*\*\*} datë

---

<sup>12</sup> Me këtë mandat, janë paguar 12 mijë euro.

25.07.2005<sup>13</sup>, kësti i tretë me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 20.07.2006, me të cilin është paguar shuma prej 4.000 eurosh.

vi) Lidhur me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se pas pagimit të këstit të dytë prej 23 mijë eurosh një nga pjesëtarët e familjes sime, gjyshja ime, pati një problem të rëndë shëndetësor, i cili kërkonte kurim të shpejtë jashtë vendit dhe një shpenzim monetar të cilin prindërit e mi për momentin nuk e përballonin dot. Për këtë arsye, pas kërkesës së babait tim, unë kam folur verbalisht me përfaqësuesin e firmës së ndërtimit “{\*\*\*}”, për të më kthyer dorazi nga vlera e këstit të dytë të paguar prej 23 mijë eurosh, një shumë prej 8 (tetë) mijë eurosh që do e përdornim për këtë rast shëndetësor urgjent. Për këtë veprim ju paraqes mandatpagesën përkatëse nr. {\*\*\*}, datë 23.5.2006, lëshuar nga përfaqësuesi i firmës që provon kthimin e shumës prej 8 mijë eurosh. Si pasojë e këtij veprimi, kësti i dytë mbeti i shlyer në vlerën 15 (pesëmbëdhjetë) mijë euro.

Subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, gjatë procesit të rivlerësimit në KPK, ka shpjeguar se pas pagimit të këstit të tretë, në shumën prej 4 mijë eurosh, ajo i detyrohej firmës nga shuma totale e apartamentit prej 39 mijë eurosh, sipas kontratës së sipërmarrjes, shumën prej 8 mijë eurosh, e cila i është paguar sipas mandatarëkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 24.7.2006, si pagesë e këstit të fundit lidhur me të<sup>14</sup>. Pra, subjekti ka shpjeguar se mandati i datës 24.7.2006 ka mbyllur detyrimet që ajo kishte ndaj shoqërisë së ndërtimit, duke u likuiduar vlera totale prej 39 mijë eurosh, për pasurinë apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë.

Bashkëlidhur këtyre përgjigjeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka depozituar deklaratën noteriale të datës 10.01.2020, që z. J. C. kishte nënshkruar në emër të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën deklaron se në datën 23.05.2006, me kërkesën e subjektit, për arsye shëndetësore familjare, i ka kthyer asaj shumën prej 8 mijë eurosh nga shuma prej 15 mijë eurosh, të paguar me këstin e dytë. Gjithashtu, në këtë deklaratë, z. J. C. deklaron se *vlerën prej 8.000 eurosh, që përfaqëson edhe likuidimin e këstit të fundit, e ka shlyer me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006, që i bashkëlidhet kësaj deklaratë.*

#### 4. Në vlerësim të kësaj situatë faktike, ndryshe nga shumica, çmoj si vijon:

i) Subjekti ka fituar të drejta reale mbi pasurinë apartament me sipërfaqe 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, me kontratën e sipërmarrjes, datë 21.09.2004, e cila referuar nenit 690 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ka fuqinë e ligjit për palët. Në përmbajtjen e kontratës përcaktohet qartësisht se vlera e apartamentit është 39 mijë euro.

ii) Bazuar në nenin 6 të ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar në deklaratën vjetore periodike të vitit 2006, shlyerjen e detyrimit financiar të mbetur ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, por jo veprimet financiare të kryera brenda vitit kalendarik, të cilat përfundimisht kanë passjellë shlyerjen e plotë të vlerës së apartamentit të dakordësuar në kontratën e sipërmarrjes. Në këtë kuptim, subjekti i rivlerësimit nuk kishte detyrim për të deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2006, tërheqjen e shumës prej 8.000 eurosh, të realizuar me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

Mbështetur në nenet 30 e vijues të ligjit nr. 84/2016, në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti duhet të deklaronte pasurinë në pronësi, burimet e krijimit dhe vlerën e saj. Legjislacioni i sipërcituar nuk përcakton detyrimin ligjor për subjektet që të deklarojnë në *vetting*, mënyrën/hapat/momentet/veprimet financiare se si janë shlyer detyrimet ndaj të tretëve për krijimin e një pasurie. Lidhur me këtë pretendim të subjektit, shumica është kontradiktore me qëndrimin e mbajtur prej saj për destinacionin e shumave të tërhequra nga kredia bankare në

<sup>13</sup> Me këtë mandat, janë paguar 23 mijë euro.

<sup>14</sup> Pasi kjo shumë i ishte kthyer nga babai, pasi gjendja e gjyshes u stabilizua pas trajtimit mjekësor në Shqipëri dhe nuk u përdor për kurimin e saj jashtë vendit.

Bankën Alpha, në paragrafin 22.7.(iii)<sup>15</sup> të vendimit. Nëse për shumicën subjekti kishte detyrimin për të deklaruar në *vetting* veprimet financiare të kryera me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK për shlyerjen e detyrimit ndaj saj, atëherë ajo do të duhet të deklaronte në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe mekanizimin/veprimet financiare të kryera dhe për kalimin e shumave të tërhequra nga kredia e Bankës Alpha të kjo shoqëri.

Vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, deklarimin për këtë pasuri në deklaratën e pasurisë *vetting* e ka bërë në përputhje me ligjin, duke e shoqëruar atë me dokumentacionin justifikues ligjor që provonte ligjshmërinë e të ardhurave që kishin shërbyer si burim për krijimin e kësaj pasurie. Bazuar në aktet e administruara në fashikull dhe të dhënat që ato përmbajnë, sjell në vëmendje se ndryshe nga sa është referuar nga shumica, se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar veprimet financiare të kryera për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, as në deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe ka dhënë shpjegime lidhur me mandatarkëtimin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2006 [për pagesën e fundit prej 8.000 eurosh], vetëm pasi ky fakt është evidentuar nga Komisioni<sup>16</sup>, rezulton se ky mandat i është bashkëngjitur prej vetë subjektit deklaratës së pasurisë *vetting*. Ky fakt rezulton i evidentuar edhe në faqen 4 të raportit të ILDKPKI-së, me të cilin është përcjellë deklarata e pasurisë *vetting*, si dhe deklaratat vjetore periodike të subjektit, në pjesën ku janë listuar dokumentet që subjekti i ka bashkëngjitur deklaratës *vetting* për këtë pasuri, konkretisht, ndër të tjera, *mandatpagesa nr. {\*\*\*}, datë 24.7.2006, nga Bernina Kondi, në vlerën 8.000 euro, për pagesë kësti të fundit për apartamentin 1+1.*

Bazuar në faktet si më sipër cituar, çmoj se do të ishte e alogjikshme që të konkludohej se subjekti i rivlerësimit ka pasur për qëllim të mos e tregojë këtë veprim financiar të kryer me shoqërinë, për më tepër të paraqiste nëpërmjet shoqërisë dokumente financiare [mandate që tregonin pagesa të tjera ndaj saj], të cilat do të kundërshtonin mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.7.2006 [për pagesën e fundit prej 8.000 eurosh], apo të mos jepte shpjegime lidhur me të. Gjithashtu, vlerësoj se duke qenë se mandati nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me të cilin kjo shoqëri i ka kthyer 8.000 euro subjektit, nuk është një mandat që tregon veprim financiar të kryer prej saj, për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë për vlerën e apartamentit, bën të besueshëm qëndrimin e subjektit që ka dhënë shpjegime lidhur me të, në momentin që është pyetur nga Komisioni për mandatin nr. {\*\*\*}, datë 24.7.2006 [për pagesën e fundit prej 8.000 eurosh].

Në vlerësim të situatës faktike më sipër trajtuar dhe në interpretim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ndryshe nga shumica, çmoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka qenë e besueshme në shpjegimet e saj për mënyrën se si janë kryer pagesat për pasurinë apartament 57 m<sup>2</sup> ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si edhe deklaratimet e saj në *vetting* për këtë pasuri kanë qenë në përmbushje të detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për rrjedhojë nuk ka qenë në kushtet e deklaramit të paplotë.

iii) Vlerësoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka qenë koherente në deklaratimet e saj, si gjatë procesit të rivlerësimit të kryer në Komision<sup>17</sup> dhe në ILDKPKI<sup>18</sup>, duke e

---

<sup>15</sup> “22.7. Në analizë të sa parashtruar më sipër, Kolegji [...] (iii) duke konsideruar parashikimet ligjore të ligjit nr. 84/2016 dhe ato të ligjit nr. 9049/2003, të cilat përcaktojnë detyrimin e subjekteve deklarues të provojnë burimet e ligjshme të financimit të pasurive të tyre dhe jo detyrimisht një mekanizëm të paracaktuar për provueshmërinë e realizimit të transaksioneve bankare në funksion të këtij qëllimi”.

<sup>16</sup> Shih paragrafin 21.8 të vendimit: “Subjekti ka dhënë një shpjegim për këtë mandat vetëm pasi Komisioni e ka evidentuar atë si një këst që rezultonte të ishte paguar, por që kishte mospërputhje me pagesat e tjera në raport me vlerën e apartamentit”.

<sup>17</sup> Përgjigjet ndaj pyetësorit nr. 3 të dërguar nga Komisioni, si dhe rezultatet e hetimit paraprak të dërguar prej tij.

<sup>18</sup> Gjatë procesit të kontrollit të kryer nga ILDKPKI-ja në vitin 2012.

konsideruar shumën prej 8.000 eurosh, si pagesën e kështit të fundit ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK.

Tërheqja nga subjekti e shumës prej 8.000 eurosh, si pjesë e paguar me këstin e dytë ndaj shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, çmoj se provohet me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 23.5.2006, një akt i cili si në aspektin formal, por dhe të përmbajtjes është në përputhje me legjislacionin për kontabilitetin dhe, për rrjedhojë, i besueshëm në drejtim të konsiderimit dhe vlerësimit të tij në harmoni me provat e tjera, për qëllim të provueshmërisë së këtij fakti. Shumica në qëndrimin e saj nuk i ka dhënë vlerë provuese këtij mandati duke e përjashtuar atë nga vlerësimi harmonik dhe i logjikshëm së bashku me provat e tjera, megjithëse nuk e ka kundërshtuar atë sa i përket formës, por edhe përmbajtjes, madje nuk ka paraqitur as dyshime për vërtetësinë e tij. Në paragrafin 21.11 të vendimit, ajo e ka mbështetur qëndrimin e saj lidhur me këtë fakt<sup>19</sup> në deklaratën noteriale të datës 10.01.2020, të J. C., si përfaqësues i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, duke e vlerësuar atë si jo të besueshme, duke qenë se deklaruesi, sipas një prokure të përgjithshme prej vitit 2011<sup>20</sup>, nuk kishte tagra përfaqësimi nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK për përfaqësim me të tretët deri në momentin kur ajo është lëshuar, si dhe duke pasur dyshime për fuqinë ligjore të prokurës, për arsye se statusi i shoqërisë, sipas QKB-së është “pezulluar”, ndërkohë që nuk bën asnjë vlerësim lidhur mandatin nr. {\*\*\*}, datë 23.05.2006, i cili është akt që është depozituar në Komision dhe shpjeguar nëpërmjet deklarimeve të z. J. C. në këtë deklaratë.

Në ndryshim nga shumica, i konsideroj bindëse shpjegimet e subjektit, lidhur me emergjencën shëndetësore të një pjesëtari të familjes dhe mbështetjen financiare që ajo do të jepte për mundësi kurimi jashtë vendit për të. Subjekti, nëpërmjet dokumentacionit spitalor të paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit në Komision, edhe pse i datave të mëvonshme se ato kur janë kryer veprimet financiare për pagesën e kështit të fundit me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, ka dashur të provojë gjendjen shëndetësore të rënduar dhe të vazhdueshme të gjyshes së saj. Vlera prej 8.000 eurosh, e cila mendohej t’i dedikohej një trajtimi shëndetësor jashtë vendit për diagnozat kronike<sup>21</sup> të rënduara të gjyshes, duket një vlerë e besueshme në rast ndërhyrje, si dhe për kohëzgjatjen e mundshme të qëndrimit të saj për këtë trajtim.

Nga ana tjetër, vlerësoj se kthimi nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK i shumës prej 8.000 eurosh, për arsye shëndetësore familjare, është një veprim financiar, i cili në terma konkret vetëm ka shtyrë në kohë shlyerjen e një pjese të kështit të dytë për t’u paguar më tej si kësht i fundit, por nëpërmjet të cilit nuk është hequr dorë apo favorizuar nga shoqëria subjekti i rivlerësimit, për shlyerjen e detyrimit, sipas vlerës së dakordësuar në kontratën e sipërmarrjes.

5. Në përfundim, duke u dhënë një peshë të posaçme rrethanave dhe provave të besueshme si më sipër trajtuar, në një vlerësim harmonik dhe të logjikshëm të tyre së bashku me provat e tjera të administruara dhe trajtuara në vendim, si dhe duke pasur në konsideratë edhe shpjegimet dhe deklaratimet<sup>22</sup> e subjektit të rivlerësimit për këtë situatë faktike, çmoj se konkluzioni i Komisionit se vlera e pasurisë apartament me sip. 57 m<sup>2</sup>, në Tiranë, është 47 mijë euro, është i pabazuar në prova dhe fakte dhe, për rrjedhojë, konkludoj se subjekti i rivlerësimit, znj. Bernina Kondi, ka bërë deklaram të saktë të vlerës së pasurisë në deklaratën

<sup>19</sup> Pra, tërheqjen nga subjekti të shumës prej 8.000 euro nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>20</sup> Veprimet financiare të subjektit datojnë shumë vite më parë, në vitet 2005-2006.

<sup>21</sup> Siç rezulton nga dokumentacioni spitalor.

<sup>22</sup> Të cilat, sipas nenit 49, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, janë mjete të kërkimit të provës.

e pasurisë *vetting*. Pavarësisht konkluzionit për këtë shkak ankimi, ashtu si edhe shumica në këtë vendim, çmova se subjekti i rivlerësimit nuk kishte arritur një nivel të besueshëm në drejtim të kriterit të vlerësimit të pasurisë, duke konkluduar që vendimi nr. 259, datë 15.06.2020, i Komisionit është marrë mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

**GJYQTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*